

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6043  
E hënë, 22 qershor 2020  
çmimi 0.40 €

Ministri Zemaj zotohet se do të qëndrojë afër punëtorëve shëndetësorë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM BAHTIRI ■ FAQE 4-5

## Presidenti do ta rrëzojë këtë qeveri

Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se qeveria Hoti është formuar për qëllime të presidentit Hashim Thaçi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo qeveri do ta ndjekë vetëm skenarin e presidentit në dialogun Kosovë - Serbi. Zyrtari i LV-së ka paralajmëruar se në fund qeveria Hoti do të rrëzohet nga ai që është formuar, Hashim Thaçi. Sipas tij, marrëveshja përfundimtare me Serbinë, e cila pritet të ndodhë këtë vit, nuk do të mund të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës



### OPINION

VIZIONI POLITIK I ADEM JASHARIT F. 11

Bedri ISLAMI



DIALOGU, KOHA E FUNDIT PËR T'U PËRFUNDUAR F. 7

Hysni GUCATI



### AKTUALE

VDES EDHE NJË PERSON ME COVID-19 NË KOSOVË F. 6

### EKONOMI

S'KA FLUTURIME NË ANP 'ADEM JASHARI' DERI MË 27 QERSHOR F. 8

A PO DËSHTON KOSOVA TA PËRFITOJË NDIHMËN FINANCIARE NDËRKOMBËTARE? F. 9

### KULTURË

CIKËL POETIK NGA VALBONA REXHEPI-HADRI F. 12-13

## A KA SHANS VJOSA PËR KRYETARE TË LDK-SË PAS SHKARKIMIT NGA POZITAT UDHËHEQËSE?



Shtatëdhjetë (70) anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë votuar për shkarkimin e Vjosa Osmanit nga posti i nënkryetares së partisë dhe anëtares së kryesisë. Nga disa anëtarë të KP të LDK-së ky vendim u cilësua jo i drejtë

dhe skandaloz. Pas këtij vendimi, Vjosa Osmani i ka porositur të gjithë ata që votuan për shkarkimin e saj, se do të shihen së shpejti në zgjedhje. Milazim Krasniqi, një nga ish-themeluesit e LDK-së, ka thënë se tash Osmani e ka rrugën e hapur të formo-

jë parti të re pasi, sipas tij, rruga e saj për ta marrë kreun e LDK-së është e mbyllur. Por mendim ndryshe ka shprehur analisti Nexhmedin Spahiu. Ai thotë se tashmë Osmani ka përkrahje të mjaftueshme për të kandiduar për kryetare të LDK-së



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Braathu: Procesi i votimit në komunat me shumicë serbe, i qetë

MITROVICË, 21 QERSHOR - Të dielën në mjediset e banuara me shumicë serbe në Kosovë qytetarët me nënshtetësi serbe kanë votuar për zgjedhjet e përgjithshme në Serbi. Procesi i grumbullimit të votave po bëhet nga misioni i OSBE-së në Kosovë.

Shefi i Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë, Jan Braathu, ka vizituar të dielën vendvotimet në Mitrovicë e Veriut dhe ka thënë se procesi i votimit është duke shkuar qetë dhe pa probleme.

Ambasadori Braathu tha se pjesëmarrja në votime është e

lartë, mbi 40 për qind në Mitrovicë të Veriut dhe mbi 55 për qind në Komunën e Leposaviqit. Sipas tij, janë duke u respektuar masat mbrojtëse kundër sëmundjes Covid-19 që e shkakton koronavirusi pasi, siç ka thënë Braathu, OSBE-ja ka siguruar maska për të gjithë votuesit dhe ka shtuar se respektimi i distancës fizike nganjëherë “është pak i vështirë” të respektohet. “Por, unë mendoj se po shkon shumë mirë. Përveç kësaj, ne po ndjekim procedurën si në vitin 2017, për të cilën janë pajtuar Prishtina dhe Beogradi”, tha Braathu, duke iu referuar një

marrëveshjeje për lejimin e “grumbullimit” të votave për zgjedhjet e Serbisë në Kosovë. OSBE-ja, sipas Braathu, ka regjistruar dy incidente të vogla, por stafi ka reaguar me kohë dhe problemet janë zgjidhur. Lidhur me votimet grupore në Mitrovicë të Veriut, ku qytetarët u shoqëruan nga liderët politikë serbë dhe ku nuk u respektua distanca fizike, Braathu tha se OSBE-ja nuk është polici dhe nuk mund t'i ndalojë njerëzit. “Ne kishim udhëzime të qarta për stafin tonë, që t'i inkurajojnë njerëzit të mbajnë distancën. Jam i vetëdijshëm që në këtë rast kjo nuk u respektua, por ne



nuk mund të bëjmë më shumë se kaq”, tha shefi i misionit të OSBE-së, Jan Braathu.

Njëzetë qendra “grumbulluese” të votave janë hapur në Kosovë në orën 7:00 dhe do të mbyllën në orën 20:00. Votat

më pas OSBE-ja do t'i transportojë në Rashkë dhe Vrajë të Serbisë, ku edhe do të numërohen. Të drejtë vote në zgjedhjet e Serbisë kanë 95 334 qytetarë me nënshtetësi serbe që jetojnë në Kosovë.

## Artan Grubi: Po kërkojmë bashkimin e votës shqiptare për kryeministrin e parë shqiptar

SHKUP, 21 QERSHOR - Që nga viti 2002 Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) në asnjë çast nuk është kyçur në fushatë të zezë kundër kundërshtarëve të vet politikë por, përkundrazi, i ka ftuar ata që të bashkohen dhe ta sfidojnë BDI-në. Kështu ka deklaruar sekretari i BDI së, Artan Grubi. Ai ka thënë se BDI-ja ka ofertë të jashtëzakonshme për zgjedhjet parlamentare në Maqedoninë e Veriut.

Më tutje, ai ka thënë se BDI-ja ka një program voluminoz, ambicioz dhe modern. “Po kërkojmë bashkimin e votës shqiptare dhe të tjerëve rreth këtij programi dhe rreth kryeministrit të parë shqiptar. Nuk do të merremi me partitë e tjera politike, por do ta prezantojmë ofertën tonë. Ndryshe nga partitë e tjera që synimin e kanë të fitojnë përballë BDI-së, synimi ynë i vetëm është që ta fitojmë besimin e qytetarëve”, ka theksuar Grubi.



## Mali i Zi mbyll kufirin, vë kushte për hyrjen e vizitorëve

Podgoricë, 21 qershor - Prej të hënës banorët e Kosovës dhe të Shqipërisë mund të hyjnë në Mal të Zi vetëm nëse paraparakisht testi për Covid-19 u del negativë. Qeveria e Malit të Zi të premten ka prezantuar vendimet për hapjen e mëtejme të kufijve të këtij vendi.

Qytetarët e Kosovës dhe të Shqipërisë për të hyrë në Mal të Zi duhet ta kenë me vete rezultatin negativ të PCR testit për SARS-CoV-2, të laboratorëve të

akredituar, thuhet në faqen zyrtare të Qeverisë së Malit të Zi. “Shtetet, banorët e të cilave mund të hyjnë në Mal të Zi me rezultat negativ të PCR testit për SARS-CoV-2 të laboratorëve të akredituar, jo më të vjetër se 48 orë: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Turqia, Izraeli, Polonia, Rumania, Italia dhe Ukraina”, thuhet në njoftimin e Qeverisë së Malit të Zi.

Sipas njoftimit, lista e vendeve

është formuluar në bazë të rasteve aktive dhe rasteve të reja me Covid-19 si dhe disa kriterëve të tjera të kësaj natyre. Lista e vendeve, banorët e të cilave nuk kanë kufizime për të hyrë në Mal të Zi, është shumë e gjatë. Duke pasur parasysh rritjen e numrit të të infektuarve me Covid-19, Trupi Kombëtar Koordinues i Malit të Zi mori vendimin për bartjen e obliguar të maskave mbrojtëse në të gjithë hapësirat publike.



# A ka shans Vjosa për kryetare të LDK-së pas shkarkimit nga pozitat udhëheqëse?

Shtatëdhjetë (70) anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë votuar për shkarkimin e Vjosa Osmanit nga posti i nënkryetares së partisë dhe anëtares së kryesisë. Nga disa anëtarë të KP të LDK-së ky vendim u cilësua jo i drejtë dhe skandaloz. Pas këtij vendimi, Vjosa Osmani ka porositur të gjithë ata që votuan për shkarkimin e saj, se do të shihen së shpejti në zgjedhje. Milazim Krasniqi, një nga ish-themeluesit e LDK-së, ka thënë se tash Osmani e ka rrugën e hapur të formojë parti të re pasi, sipas tij, rruga e saj për ta marrë kreun e LDK-së është e mbyllur. Por mendim ndryshe ka shprehur analisti Nexhmedin Spahiu. Ai thotë se tashmë Osmani ka përkrahje të mjaftueshme për të qenë kandidate për kryetare të LDK-së



**EPOKA ERE** Mal QORRAJ

PRISHINË, 21 QERSHOR - Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka shkarkuar Vjosa Osmanin nga posti i nënkryetares së partisë dhe anëtares së kryesisë, kurse Osmani i ka paralajmëruar të gjithë ata që votuan për largimin e saj nga këto pozita, se do të shihen së shpejti në zgjedhje.

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka njoftuar se për shkarkimin e Osmanit nga posti i nënkryetares dhe anëtares së kryesisë kanë votuar për 70 anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm, 16 kanë qenë kundër dhe 28 nuk kanë marrë pjesë në votim, i cili është zhvilluar në mënyrë elektronike. Mustafa ka njoftuar se Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së ka votuar që Avdullah Hoti ta marrë postin e nënkryetarit të partisë. "Kam nderin t'ju njoftoj se deri në përfundim të afatit të shprehjes së qëndrimit tuaj, më 20 qershor 2020, në orën 19:00, pyetjeve: A e përkrahni propozimin që z. Avdullah Hoti të jetë nënkryetar i LDK-së, nga 123 anëtarë aktualë të Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së, janë përgjigjur 99 anëtarë, prej tyre 92 janë shprehur për (po), 3 janë shprehur kundër (jo), 4 kanë abstenuar dhe 24 nuk janë përgjigjur, s'kanë marrë pjesë në votim. Ndërsa për sa i përket propozimit për lirimin e znj. Vjosa Osmani nga pozita e nënkryetares dhe nga kryesia e LDK-së, nga 123 anëtarë aktualë të Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së janë përgjigjur 95 anëtarë, prej tyre 70 janë shprehur për (po), 16 janë shprehur kundër (jo), 9 kanë abstenuar dhe 28 nuk janë përgjigjur, s'kanë marrë pjesë në votim. Në bazë të kësaj, si kryetar i LDK-së konstatoj se Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës vendosi që: z. Avdullah Hoti të zgjedhet nënkryetar i LDK-së, znj. Vjosa Osmani të lirohet nga pozita e

nënkryetares së LDK-së dhe anëtares së kryesisë", ka thënë Mustafa në deklaratën për media. Pas shkarkimit, Vjosa Osmani përmes një reagimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ajo u diferencua nga partia e tij sepse, siç ka thënë, nuk ka ndryshuar qëndrimet e veta. "Po përjashtohem e diferencohem sepse: Thashë kurrë me të korruptuarit, dhe ashtu mbeti; Thashë do t'i sjellim Kosovës ndryshimin e jo mendësinë e vjetër në pushtet, dhe ashtu mbeti; Thashë se nuk do ta përkrahë asnjë tregtar të kufijve e të sovranitetit, dhe ashtu mbeti. Thashë për Kosovën do të kërkojmë barazi nëpërmjet reciprocitetit, dhe ashtu mbeti; Thashë se askujt nuk do t'i punojmë pas shpine, dhe ashtu mbeti; Pra, u diferencova e shkarkova sepse e mbajta fjalën. U diferencova edhe për shkak se jam grua, sepse asnjë nënkryetar burrë në të kaluarën, edhe kur kanë kundërshtuar e vepruar kundër vendimeve të partisë, nuk janë përjashtuar", ka thënë ajo. Osmani ka theksuar se vetëm qytetarët mund ta rrëzojnë atë nga postet udhëheqëse, andaj i ka porositur të gjithë ata që votuan që të shkarkohej, se do të shihen së shpejti në zgjedhje. "I falënderoj 53 anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm që nuk u bënë pjesë e këtij diferencimi politik. Ndërsa për diferencuesit e sotëm, shihemi në garën zgjedhore së shpejti. E aty do ta shohim se kush do të fitojë kur të dalim para qytetarëve. Gara e vërtetë është para qytetarëve, edhe pse shumica dërrmuese prej jush diferencues, jeni aq frikacakë sa nuk do të guxonin të dilnin në atë përballje, por sërish do të fshihen prapa dikujt tjetër. Por përballja e madhe do të ndodhë. Mua më ka ngritur populli dhe vetëm ai do të mund të më rrëzojë", ka thënë Osmani.

Ndërkaq deputeti i LDK-së, Haxhi Avdyli, e ka cilësuar "vendim skandaloz" shkarkimin e Osmanit nga postet udhëheqëse në parti.

Për shkarkimin e Vjosa Osmanit nga pozitat udhëheqëse ka reaguar edhe kryetari i Komunës së Vushtrisë nga radhët e LDK-së, Xhafer Tahiri. Ai ka thënë se "Lidhja Demokratike e Ibrahim Rugovës nuk e ka pasur praktikë t'i përjashtojë njerëzit e vet, aq më pak nënkryetaren e vet, kandidaten e parë grua për kryeministre për shkak të mendimit ndryshe".

Tahiri ka shtuar se në ADN-në e LDK-së është liria e mendimit, liria e individit. "Dr. Vjosa Osmani ka mbrojtur parimet për të cilat ka kërkuar besimin e votuesve të LDK-së. Të gjithë e kemi ditur që Vjosa nuk i ndryshon parimet e saj, të gjithë e kemi kërkuar në krye të listës së LDK-së dhe të gjithë e kemi përkrahur", është shprehur ai, duke bërë me dije se vota e tij si anëtar i Këshillit të Përgjithshëm i LDK-së ishte kundër shkarkimit të Osmanit nga pozitat udhëheqëse në këtë parti.

Përjashtimin e Vjosa Osmanit e kanë komentuar edhe analistët politikë.

Milazim Krasniqi, një nga ish-themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, aktualisht profesor universitar, ka thënë se për ta kuptuar shkarkimin e Vjosa Osmanit duhet të kuptohet cili është parimi themelor partiak, obligimi statutar dhe momenti kur ndodhi shkarkimi. "Parimi është se nuk mund të veprosh kundër vendimeve të partisë tënde. Mund të kesh mendim ndryshe, por kur miratohet një vendim, respektimi i tij bëhet obligues. Obligim është të respektohen vendimet e partisë. Sa i përket momentit të shkarkimit, Isa Mustafa ka shfrytëzuar momentin ideal, kur është më i

fortë se kurrë. Pse? Sepse LDK-ja udhëheq qeverinë, dmth. ka mundësi të japë poste në të katër anët, me çka i shukatë ata që do ta përkrahnin Vjosën në ndonjë moment tjetër", ka thënë Krasniqi. Ai ka theksuar se, po ashtu, LDK-ja është në pikën e lartë të partneritetit me ShBA-në, në prag të takimit të Uashingtonit. "Me PDK-në e hutuar në opozitë e me LV-në e dërrmuar në raport me ShBA-në, LDK-ja ka mbetur e vetmja shpresë për një zgjedhje ala Grenell. Shkurt: Vjosa ka thyer parimin dhe obligimin partiak, po edhe ka hyrë në konflikt me partinë e vet në momentin më të keq për veten. Tash e ka rrugën e hapur të formojë parti të re. Por, rrugën për ta marrë kreun e LDK-së ia ka mbyllë vetes me ferrë", ka deklaruar Krasniqi.

Analisti Nexhmedin Spahiu ka deklaruar për "Klan Kosova" se shkarkimi i Vjosa Osmanit nga pozitat drejtuese të LDK-së do ta dëmtojë këtë subjekt politik. "Votimi për shkarkimin e Vjosa Osmanit nga pozitat drejtuese të LDK-së është një luftë e brendshme politike brenda këtij subjekti politik. Ajo, në bazë të së cilës LDK-së i ka shtuar më së shumti vota, nuk i jepet mandati për kryeministre, plus edhe shkarkohet", ka thënë ai.

Spahiu ka theksuar se rezultati i votimit nuk tregon se Osmani është një figurë përçarëse, por që ajo ka një peshë bajagi të madhe në LDK. "Nga 123 vota në Këshillin e Përgjithshëm drejtues të LDK-së, vetëm 70 ishin për shkarkimin e saj; që do të thotë se ky inicim për shkarkim ka qenë një dështim i Isa Mustafës duke marrë parasysh që ai, në fakt, drejton Qeverinë e

Kosovës sepse e ka zgjedhur njeriun e vet aty - Avdullah Hotin. Nga rezultati i votimit del se Vjosa Osmani ka një autoritet jo vetëm në mesin e anëtarësisë së gjerë të LDK-së dhe simpatizantëve të saj që është dëshmuar në zgjedhjet e 6 tetorit, por edhe në organin e LDK-së më të lartë drejtues", ka thënë ai. Sipas profesorit Spahiu, ndarje të partisë nuk do të ketë, por kjo bën që në zgjedhjet e ardhshme Osmani të jetë kandidate serioze për kreun e partisë. "Mendoj se ajo tashmë ka përkrahje të mjaftueshme për të qenë kandidate për kryetare të partisë, kështu që ky inicim për shkarkim shkon në favor të saj", është shprehur Spahiu.

Vjosa Osmani, e cila është kryetare e Kuvendit të Kosovës, kishte shprehur publikisht pakënaqësitë e saj lidhur me prishjen e koalicionit në mes të LDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje në mars të këtij viti.

Gjatë mocionit të mosbesimit të ngritur nga LDK-ja më 25 mars, ndaj qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti, Osmani kishte votuar kundër.

Osmani u zgjodh në krye të kuvendit me propozimin e partisë fituese të zgjedhjeve, Lëvizjes Vetëvendosje dhe vazhdon ta mbajë atë pozitë edhe pas rrëzimit të qeverisë LV-LDK.

Vjosa Osmani është shprehur kundër edhe qeverisë së re të formuar nga LDK-ja që udhëhiqet nga Avdullah Hoti. Në seancën e 3 qershorit, kur u votua për qeverinë e udhëhequr nga LDK-ja, Osmani nuk mori fare pjesë. Në zgjedhjet e 6 tetorit të vitit 2019 Osmani ishte kandidate e LDK-së për kryeministre.

FLET PËR “EPOKËN E RE”, AGIM BAHTIRI

# PRESIDENTI DO TA RR



Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se qeveria Hoti është formuar për qëllime të presidentit Hashim Thaçi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se kjo qeveri do ta ndjekë vetëm skenarin e presidentit në dialogun Kosovë - Serbi. Zyrtari i LV-së ka paralajmëruar se në fund qeveria Hoti do të rrëzohet nga ai që është formuar, Hashim Thaçi. Sipas tij, marrëveshja përfundimtare me Serbinë, e cila pritet të ndodhë këtë vit, nuk do të mund të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës

qytetarëve dhe e cila kishte filluar të punojë mjaft mirë. Kjo tregon se shteti mbetet ende i kapur”, ka thënë ai, duke shtuar se në zgjedhjet e ardhshme qytetarët do t’ua kallëzojnë vendin atyre që nuk mbajtën fjalën.

Bahtiri ka paralajmëruar se marrëveshja me Serbinë nuk do të mund të ratifikohet në Kuvend. Sipas tij, ajo do të kundërshtohet fuqishëm nga qytetarët e Kosovës. “Ai mendon se marrëveshjen do ta bëjnë këtë vit, por ju do ta shihni se qytetarët do të reagojnë shumë ashpër ndaj kësaj marrëveshje, duke e pamundësuar votimin e saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Do të thotë, ata nuk do të mund të bëjnë asgjë, sepse ratifikimi i marrëveshjes në Kuvend nuk do të mund të ndodhë”, është shprehur ai. Zyrtari i LV-së e ka komentuar edhe takimin e Uashingtonit që do të mbahet më 27 qershor.

“Mendoj se në takimin e 27 qershorit nuk do të ketë marrëveshje përfundimtare. Tani është pak më ndryshe. Në këtë takim besoj se do t’i përcaktojnë kornizat kryesore të procesit. Ky maliverzim që ka ndodhur dhe do të ndodhë, nuk do të jetë asgjë më shumë ose më pak sesa e ka paraparë Hashim Thaçi”, ka deklaruar Bahtiri.

**“Epoka e re”:** Z. Bahtiri, zgjedhjet parlamentare të Serbisë po mbahen edhe në territorin e Kosovës. Cili është qëndrimi juaj për këtë çështje?

**Bahtiri:** Për këtë çështje nuk mund të deklarojmë krejtësisht, sepse nuk e di se cili është statusi i tyre. Sepse ata mund të jenë qytetarë të Serbisë që jetojnë në Kosovë, por ata qytetarë që janë shtetas të Kosovës është e padrejtë dhe e papranueshme që të marrin pjesë në këto zgjedhje. Ata do të

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, e ka kritikuar qeverinë Hoti se e ka marrë pushtetin në mënyrë të padrejtë. Ai ka thënë se këtë qeveri e ka formuar presidenti Hashim Thaçi për ta arritur marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, anëtari i

Këshillit të Përgjithshëm të LV-së ka deklaruar se në fund kjo qeveri do të rrëzohet nga Hashim Thaçi. “Unë mendoj se këtë qeveri e ka bërë në mënyrë taktike presidenti Hashim Thaçi për qëllime personale. Do të shihni në fund se si do të bjerë kjo qeveri dhe do të shihni të gjithë se kush do ta shkarkojë. Pra, ai që e ka formuar këtë qeveri, ai do ta shkarkojë porsa ta përfundojë puna e vet”, ka thënë Bahtiri.

Ai ka vlerësuar se qeveria Hoti vetëm do ta zbatojë planin e presidentit në procesin e negociatave me Serbinë. “Kjo qeveri është e kapur. Kjo qeveri ka përfituar prej situatës dhe e ka grabitur pushtetin pa të drejtë. Kjo qeveri nuk bën asgjë tjetër përveç zbatimit të planit të Hashim Thaçit i cili synon që brenda mandatit të vet të arrijë një marrëveshje me Serbinë. Kjo qeveri ka rrëzuar një qeveri legjitime, e cila ishte vullnet i

# ËZUJË KËTË QEVERI



që tashmë po qeverisin, më herët e kanë kritikuar qeverinë Kurti se gjatë pandemisë kishte hapur kufirin me Serbinë, ndërsa tani kanë lejuar mbajtjen e zgjedhjeve serbe?

**Bahtiri:** Kritikat e këtyre subjekteve politike ndaj qeverisë Kurti për këtë çështje kanë qenë të padrejta. Sepse kufijtë janë hapur për çështje humanitare dhe për njerëz profesionalë të shëndetësisë. Duhet ta dimë se një pjesë e serbëve që jetojnë në Kosovë më shumë i besojnë personelit mjekësor serb. Mendoj se koronavirusi nuk njihet nacionalitet dhe në këtë drejtim ndihma e Serbisë për Kosovën ka qenë humanitare dhe gjithçka që është e tillë është e pranueshme për secilin qytetar dhe secilin shtet.

**“Epoka e re”:** Lëvizja Vetëvendosje e ka kundërshtuar qeverinë Hoti, duke e quajtur qeveri jolegitime. Cili është qëndrimi juaj për këtë qeveri?

**Bahtiri:** Kjo qeveri është e kapur. Kjo qeveri ka përfituar prej situatës dhe e ka grabitur pushtetin pa të drejtë. Kjo qeveri nuk bën asgjë tjetër përveç zbatimit të planit të Hashim Thaçit i cili synon që brenda mandatit të tij të arrijë një marrëveshje me Serbinë. Kjo qeveri ka rrëzuar një qeveri legjitime, e cila ishte vullnet i qytetarëve dhe e cila kishte filluar të punojë mjaft mirë. Kjo tregon se shteti mbetet ende i kapur. Në zgjedhjet e ardhshme do të shohim se si qytetarët do t'i ndëshkojnë të gjithë ata që kanë keqpërdorur vullnetin qytetar dhe i kanë gënjyer ata. Unë po shoh çdo ditë pakënaqësinë e qytetarëve me këtë qeveri sepse ata kanë votuar për diçka tjetër.

**“Epoka e re”:** Nga kush është e kapur kjo qeveri?

**Bahtiri:** Unë mendoj se këtë qeveri e ka bërë në mënyrë taktike presidenti Hashim Thaçi për qëllime të tij personale. Do të shihni në fund se si do të bjerë kjo qeveri dhe do të shihni të gjithë se kush do ta shkarkojë. Pra, ai që e ka formuar këtë qeveri, ai do ta shkarkojë porsa ta përfundojë punën e vet.

**“Epoka e re”:** Kur mendoni se presidenti mund ta përfundojë punën e vet?

**Bahtiri:** Ai do të përpiqet që sa më shpejt ta bëjë marrëveshjen përfundimtare me Serbinë sepse, siç e dimë, mandati i tij përfundon brenda pak muajve.

**“Epoka e re”:** Ju mendoni se marrëveshja mund të bëhet këtë vit?

**Bahtiri:** Ai mendon që marrëveshjen ta bëjë këtë vit, por ju do ta shihni se qytetarët do të reagojnë shumë ashpër ndaj marrëveshjes, duke e pamundësuar votimin e saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Do të thotë, ata nuk do të mund të bëjnë asgjë sepse ratifikimi i marrëveshjes në Kuvend nuk do të mund të ndodhë.

**“Epoka e re”:** Pse Lëvizja Vetëvendosje nuk pranoi ftesën

e kryeministrit Hoti për konsultime rreth takimit që Kosova dhe Serbia do ta kenë më 27 qershor në Uashington?

**Bahtiri:** Lëvizja Vetëvendosje, kur ka qenë në pushtet, ia ka pamundësuar presidentit që t'i udhëheqë negociatat, pra këtë përgjegjësi e ka marrë kryeministri. Dhe, siç dihet, ish-kryeministri Kurti ka dashur që të shkojë në procesin e dialogut për të biseduar e jo për t'iu bashkangjitur një tavoline për të nënshkruar marrëveshje. Tani kjo qeveri po ia mundëson që këtë proces të udhëheqë presidenti i vendit. Hashim Thaçi dëshiron të ketë pushtet më shumë sesa i takon si president.

**“Epoka e re”:** Çfarë pritni nga takimi i 27 qershorit në

Uashington?

**Bahtiri:** Mendoj se në takimin e 27 qershorit nuk do të ketë marrëveshje përfundimtare. Tani është pak më ndryshe. Në këtë takim besoj se do t'i përcaktojnë kornizat kryesore të procesit. Ky maliverzim që ka ndodhur dhe do të ndodhë, nuk do të jetë asgjë më shumë ose më pak sesa e ka paraparë Hashim Thaçi.

**“Epoka e re”:** Çfarë ju bën të bindur se gjithçka do të shkojë sipas skenarit të presidentit?

**Bahtiri:** Unë mendoj se ai e ka jetë a vdekje këtë punë. Për këtë arsye ai po shkon në atë drejtim. Përndryshe, pse u ka shkruar deputetëve në orët e vona të natës, për t'u bërë presion për ta votuar këtë qeveri?!

## Ministri Zemaj zotohet se do të qëndrojë afër punëtorëve shëndetësorë

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar të dielën Klinikën Infektive në Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës, ku me drejtuesit e kësaj klinike janë marrë vesh për ndërmarrjen e veprimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Zemaj është zotuar se do të qëndrojë afër punëtorëve shëndetësorë, sidomos në

këtë kohë pandemie. “Sot vizitova Klinikën Infektive të QKUK-së. Bashkë me drejtorin e ShSKUK-së dhe stafin e Klinikës u pajtuam për hapat e ardhshëm në përpjekjet tona institucionale për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit. Si ministër dhe si Qeveri e Kosovës zotohem se do të jemi afër në çdo kohë. Për të kaluar sa më lehtë kjo gjendje e pandemisë, shumë

shpejt do ta kemi edhe strategjinë e testimit dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore në gjithë Kosovën. Shfrytëzova rastin që ta vizitoj edhe Qendrën e Emergjencës, për ta falënderuar dhe për ta përkrahur stafin shëndetësor që është në gjendje gatishmërie 24 orë. Bashkë do t'ia dalim!”, ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në “Facebook”.



duhej të merrnin pjesë vetëm në zgjedhjet që i organizon shteti i Kosovës. Ata që i kanë dy shtetësi duhet të përcaktohen se në cilat zgjedhje duhet të marrin pjesë.

**“Epoka e re”:** Për shkak të pandemisë, institucionet e Kosovës kanë shtyrë mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut, ndërsa për zgjedhjet serbe nuk po paraqet problem pandemia.

**Bahtiri:** Mendoj se Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës do të japë dritën e gjelbër për mbajtjen e zgjedhjeve në Mitrovicë dhe Podujevë. Tani nuk e di se si do të rrjedhë situata, por unë mendoj se nëse Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik lejon mbajtjen e zgjedhjeve, ato duhet të mbahen.

**“Epoka e re”:** Subjektet politike

## Vdes edhe një person me Covid-19 në Kosovë

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Një 52-vjeçar i infektuar me Covid-19 ka vdekur në Klinikën Infektive të Qendrën Klinike Universitare. Në njoftimin e QKUK-së thuhet se pacienti me inicialet E. K. nga

Komuna e Rahovecit ka vdekur në orët e mëngjesit të së shtunës.

Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i ka shprehur ngushëllime familjes së të ndjerit. "Ju lutem t'u përmbaheni të gjitha reko-

mandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shtabit të Posaçëm Komunal. Mbani distancën fizike për së paku dy metra dhe aplikoni masat e nevojshme higjienike", ka

shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook".

Që prej shfaqjes së rasteve të para me Covid-19, në Kosovë kanë vdekur 36 pacientë. Sipas të dhënave të fundit, numri i përgjithshëm i të infektuarve me Covid-19 në



Kosovë është 2 073, prej tyre 1 018 pacientë janë shëruar.

## Thaçi: Jemi krenarë me ushtrinë e Kosovës

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka shkruar të dielën një postim në llogarinë e vet në "Facebook" për datën e lirisë së Kosovës 21 vjet më parë. Thaçi ka thënë se pas jetësimit të aspiratave për pavarësi në vitin

2009 u themelua Forca e Sigurisë së Kosovës dhe fund të vitit 2018 u themelua edhe ushtria e Kosovës që, sipas tij, rrugëtimi i ushtrisë sonë ishte rrugëtimi i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. "Kosova e fitoi lirinë para 21 vjetëve. Në ditët e para

të lirisë filloi edhe transformimi politik dhe shoqëror i vendit tonë. Me marrëveshje me aleatët tanë dhe NATO-n filloi demilitarizimi dhe transformimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Pas

jetësimit të aspiratave për pavarësi, në vitin 2009 e themeluan Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në fund të vitit 2018 e themeluan edhe ushtrinë e Kosovës. Rrugëtimi i ushtrisë sonë ishte rrugëtimi i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Nderime

dhe respekt për të gjitha gratë dhe burrat që sakrifkuan gjithçka për këtë ditë. Jemi krenarë me ushtrinë e Kosovës, e cila së shpejti do të jetë pjesë e misioneve paqësore të NATO-s kudo nëpër botë", ka shkruar Thaçi.



## LV-ja: Mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, cenim i sovranitetit shtetëror



PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka kundërshtuar mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë në Kosovë, duke thënë se kjo paraqet cenim të "integritetit dhe sovranitetit shtetëror" pasi, sipas LV-së, Serbia me këtë rast po e trajton Kosovën "efektivisht si pjesë të saj". "Serbët e Kosovës më 21 qershor nuk do të votojnë si votues jashtë vendit me shtetësi të dyfishtë, duke votuar përmes postës apo në Zyrën Ndërlidhëse në Prishtinë, por si shtetas brenda Serbisë dhe në

qendra të votimit të hapura nga autoritetet serbe nëpër komunat e Republikës së Kosovës", thuhet në reagimin e Vetëvendosjes të postuar në rrjetin social "Facebook". Sipas LV-së, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Avdullah Hoti i LDK-së, me lejin e mbajtjes së këtyre zgjedhjeve ka legjitimuar pretendimet e Serbisë. "Është përpjekje tinëzare e qeverisë së përmbytur në varësinë nga Lista Serbe se, kinse, nuk po votohet në Kosovë, por vetëm po grumbullohen votat nga

OSBE-ja. Qeveria e demaskuar tashmë po përpjeket ta maskojë mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Kosovës, që do të mbahen sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Serbisë, të organizuara nga autoritetet e saj në mes të ditës dhe në kundërshtim të hapur me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës", thuhet në reagimin e LV-së. Të dielën qytetarët serbë që banojnë në komunat me shumicë serbe në Kosovë do të votojnë për zgjedhjet parlamentare serbe.

## PDK-ja kërkon që të themelohet Muzeu i Dhimbjes në Stacionin e Trenit në Prishtinë

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare të Refugjatëve, deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Eliza Hoxha, nëpërmjet një performance në Stacionin e Trenit në Prishtinë, ka bërë thirrje që sa më shpejt të themelohet Muzeu i Dhimbjes që kujton eksodin e qytetarëve të Prishtinës, ide kjo e iniciuar nga kryetari i PDK-së, Kadri

Veseli. Deputetja Eliza Hoxha shprehu falënderim për Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Malin e Zi që hapën në atë kohë kufijtë dhe shtëpitë e tyre për qytetarët e Kosovës. Ajo ka falënderuar edhe organizatat ndërkombëtare që ndihmuan të gjithë refugjatët për ta ruajtur dinjitetin minimal dhe për të shpresuar, si dhe të gjitha

shtetet perëndimore që hapën dyert e aeroplanëve për t'i pranuar refugjatët në vendet e tyre. Po ashtu, ajo falënderoi UÇK-në dhe NATO-n që mundësuan çlirimin e Kosovës për rikthimin në shtëpi dhe kërkoi që ky stacion, sa më shpejt të shndërron në Muze të Dhimbjes, për të memorizuar historinë e re të Kosovës dhe rëndësinë që ajo ka për brezat e rinj.



# DIALOGU, KOHA E FUNDIT PËR T'U PËRFUNDUAR



## Hysni GUCATI

Pas dhënies së mendimit këshilldhënës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) rreth aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 shtator 2010, miratoi rezolutën e sponsorizuar nga 27 vendet e atëhershme të Bashkimit Evropian dhe Serbisë, e cila hapi rrugë për fillimin e dialogut Kosovë - Serbi të lehtësuar nga BE-ja. Kjo rezolutë u miratua me konsensus nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Dialogu me Serbinë është karakterizuar nga ndërprerje dhe vonesa të kohëpaskohëshme si pasojë e tensioneve qoftë të brendshme apo edhe ndërmjet dy vendeve. Në veçanti, zgjedhjet nacionale në të dy vendet gjatë vitit 2014 shkaktuan vonesa të mëdha në zhvillimin e dialogut. Së fundmi, dialogu ishte pezulluar me anë të një rezolute të Kuvendit të Kosovës në mars të vitit 2017, pas arrestimit të Ramush Haradinajt në Francë. Që të mos zgjatemi me historikun e bisedimeve, secila Qeveri e Kosovës gjerë më tani dialogun me Serbinë e ka neglizhuar dhe bisedimet Kosovë - Serbi kanë qenë të dështuara. Këtë radhë qeveria Hoti e ka rastin dhe shansin e madh historik për t'i dhënë fund dialogut Kosovë - Serbi, temës më të ndjeshme dhe më me peshë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Dialogu Kosovë - Serbi, siç dihet, ishte proces i dështuar dhe i pasukseshëm. Pos kësaj,

stërzgatja e tij nga paaftësitë tona dhe presioni i madh i Rusisë e Serbisë për të përfituar në kohë që ky proces mos të zgjidhet shpejt, solli pasoja të mëdha në zhvillimin e vendit, por edhe krijoi defekte që janë të vështira për t'u riparuar. Shumëkush edhe mund të pyesë cilat janë këto defekte. Së pari po e përmendi eksterritorialitetin që është bregë dhe plagë e jona që e pengon procesin zhvillimor të vendit, së dyti, fusnota e cila në një mënyrë a në tjetrën e defaktorizon shtetësinë e Kosovës. Fusnota është një hallkë që e lidhë Kosovën dhe Serbinë në një varg procesesh zyrtare. U bënë 20 vjet që Serbia i mbanë pengë mbi 1 500 persona shqiptarë të Kosovës të cilët konsiderohen të zhdukur. Pothuajse askush në Serbi nuk është dënua për krimet e kryera në Kosovë. Për hatër të minoritetit serb, që është minoriteti më i privilegjuar në botë, serbët i përdorin dy parë tabela për veturat e tyre. Disa sektorë shtetërorë nëpër enklava (vende ku minoriteti serb është shumicë), nuk i zbatojnë ligjet e Kosovës, këtu bënë pjesë një sektor i arsimit, shëndetësisë etj. Deri më tani janë arritur mbi 32 marrëveshje në nivelin teknik dhe politik në mes të Kosovës dhe Serbisë, shumica prej këtyre marrëveshjeve kanë adresuar çështje me rëndësi për jetën e qytetarëve, por që pothuajse asnjëra nuk ka gjetur zbatueshmëri nga Serbia, edhe ndonjë marrëveshje që ka gjetur zbatueshmëri, është zbatuar njëanshëm. Për këtë arsye

formati i bisedimeve kësaj radhe duhet ta marrë formën përfundimtare duke i dhënë fund dialogut Kosovë - Serbi dhe arritjen e një marrëveshje finale ku Kosova nuk do të dëmtohet siç ka ndodhur në bisedimet e mëshme Kosovë - Serbi. Si pasojë e kësaj, Kosova ende nuk e ka të shtrirë sovranitetin në të gjithë territorin e vet. Minoritetit serb i mungojnë transparenca dhe llogaridhënia për shkak të instrumentalizimit të tij nga pushteti i Beogradit. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, Serbia në vazhdimësi është angazhuar në mënyrë aktive për ta penguar forcimin e brendshëm dhe konsolidimin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, Serbia ka vazhduar të llojë dhe pengojë konsolidimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Me një fjalë, bisedimet dhe marrëveshjet e deritanishme Kosovë - Serbi nuk kanë asgjë të definuar përveç se pakicës serbe i kanë dhënë të drejta që e diskriminon shumicën shqiptare. Shkëmbimi territorial në dëm të Kosovës lë probleme të hapura të natyrave të armatosura dhe hapë probleme që me vështësi mund të hyjnë në binarë. Dialogu gjatë qeverisë Thaçi II (2011-2014) arriti një marrëveshje në Bruksel e cila precizon se "do të ketë një komandant regional të policisë për katër komunat me shumicë serbe, i cili do të jetë i nacionalitetit serb, si dhe parimet e përgjithshme për integrimin e autoriteteve gjyqësore paralele në kuadër të kornizës së sistemit juridik të Republikës së Kosovës". Kurse

dialogu gjatë qeverisë Mustafa (2014-2017) në përgjithësi pësoi goditje të mëdha, veçanërisht me angazhimin e diplomacisë serbe kundër njohjes së shtetit të Kosovës apo anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe INTERPOL, si dhe murin e ndërtuar në urën e Mitrovicës në një kohë kur pritej hapja e kësaj ure. Më vonë, me vendimin e Qeverisë së Kosovës më 12 janar 2018, në bazë të kërkesës së BE-së, kryeministri Haradinaj emëroi shefin e stafit të tij, Avni Arifi, shef të negociatave me Serbinë. Në këtë kohë kryeministri Haradinaj në një mbledhje të qeverisë argumentoi se "dialogu politik përfaqësohet nga presidenti Hashim Thaçi, ndërsa shefi i negociatave do të jetë në gjendje ta përcjellë rrjedhën e vendimarrjeve në politikë. Po në këtë periudhë, më 15 janar 2018, BE-ja ftoi palët për ta vazhduar dialogun teknik dhe për të diskutuar për zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Ndërsa pala e Kosovës filloi takimet me zyrtarët e lartë, në po të njëjtën ditë, në Mitrovicë të veriut u vra lideri serb i partisë SDP, Oliver Ivanoviq. Për këtë arsye pala serbe u tërhoq nga bisedimet duke kërcënuar me moskthim në dialog deri në zbardhjen e kësaj vrasjeje. Me këtë dua të them se Kosova ende mbetet vendi i vetëm i Ballkanit perëndimor pa një të ardhme të qartë të anëtarësimin në Bashkimin Evropian, por edhe të pavarësimin të plotë nga Serbia. Për më tepër, mundësia e ricaktimit të kufijve sipas disa shteteve të rajonit, mund të ketë pasoja negative për stabilitetin e

rajonit, meqë kërkesa të ngjashme mund të vijnë nga Bosnjë e Hercegovina, Maqedonia apo Mali i Zi. Përderisa Marrëveshja e Brukselit është mjaft teknike në esencë, plani i Ahtisarit e sheh të ardhmen e Kosovës si një shoqëri shumetnike, e qeverisur në mënyrë demokratike dhe në respektim të plotë të sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Megjithatë, asnjëri prej këtyre dy dokumenteve, të paktën deri më sot, nuk janë zbatuar në praktikë. Kosova, edhe pse është me një popullsi shumicë mbi 90 për qind shqiptarë, në bisedime është konsideruar si vend shumetnik. Padrejtësitë që i janë bërë Kosovës nga viti 2000 e gjerë më sot e kanë plagosur rëndë progresin e Kosovës. Këto plagë kërkojnë shërim. Për shumë kënd, dialogu ka qenë më shumë një dialog i elitave sesa një proces që i adreson nevojat e qytetarëve dhe realitetin e tyre. Për momentin, është vështirë të arrihet një konsensus në Kosovë për t'i dhënë pakicës serbe më shumë sesa parashikon plani i Ahtisarit, teksa në të njëjtën kohë është më se e pamundshme që shumica e serbëve ta mbështesin njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Problemet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë rritur shumë, pengesat e vazhdueshme të Serbisë në shtetndërtimin e Kosovës i kanë tejkaluar caqet e ç'do durimi të mundshëm, prandaj e vetmja rrugë për tejkalimin e kësaj krize para eksplodimit është zgjedhja përfundimtare e bisedimeve Kosovë - Serbi.

# Hoti thotë se duhet të promovohet turizmi malor i Kosovës

PEJË, 21 QERSHOR (ER) - Kryeministri Avdullah Hoti ka vizituar Komunën e Pejës si dhe bujtinat turistike në fshatrat Drelaj, Shkrel dhe Stankaj të kësaj komune.

Hoti bashkë me anëtarët e kabinetit qeveritar fillimisht është pritur nga kryetari i kësaj komune, Gazmend Muhaxheri, ku kanë diskutuar për bashkërendimin e aktiviteteve dhe për t'i ndërtuar strukturat e nevojshme për ta luftuar pandeminë dhe për t'i ndarë opinionet e tyre se si do të jenë të përfshira komunat në fondin

për rimëkëmbje ekonomike që është pjesë e buxhetit tani më prej 384 milionë euro.

Ai ka bërë me dije se pas kësaj do të vazhdojnë bashkë me ecje në bjeshkët e Rugovës si formë e promovimit të turizmit malor. "Do të shkojmë nga një bujtinë në bujtinë tjetër për t'i promovuar resurset malore të Rugovës edhe për të biseduar, edhe me pronarët e atyre bujtinave për mbështetjen që duhet t'ua japim atyre për ta gjallëruar aktivitetin ekonomik në bjeshkët e Rugovës", ka theksuar kryeministri Hoti.

Ndërkaq kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka thënë se pati nderin ta kishte në vizitë kryeministrin Hoti me zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj dhe ministrat Vlora Dumoshi, Arban Abrashi, Besian Mustafa, ku e njoftuan atë për gjendjen aktuale në Komunën e Pejës, me sfidën që po përballen me virusin Covid-19 dhe me problemet ekonomike që i ka Komuna e Pejës dhe bizneset që operojnë në këtë komunë.

Kryeministri Hoti gjatë vizitave të disa prej bujtinave turistike në

Komunën e Pejës, pasi i ka përgëzuar pronarët e tyre për mikpritjen, ka treguar se ka dalë për dy qëllime në Komunën e Pejës: t'i ftojë të gjithë qytetarët që ta vizitojnë këtë vend dhe ta tregojnë qasjen e tyre që do të kenë si mbështetje për 87 bujtinat e Komunës së Pejës ku, siç u shpreh ai, është bërë një punë e madhe që gjithë këto bjeshkë janë vendosur në hartën evropiane të turizmit malor. "Sivjet kanë përjetuar kohë jo shumë të favorshme nga ata 65 mijë vizitorë që kanë pasur vitin e kaluar, sivjet kanë pasur

shumë më pak, por unë shpresoj që tash e tutje t'i kthejmë vizitat, të kthehet turizmi, të kthehet aktiviteti ekonomik në këtë pjesë. Ne sot do të vizitojmë disa bujtina dhe do t'ua bëjmë të qartë pronarëve të këtyre bujtinave, mikpritësve të Bjeshkëve të Rugovës se do t'u qëndrojmë afër me planin tonë për rimëkëmbje ekonomike", ka thënë Hoti në fjalën e tij para mediave.

Ai ka shtuar se bashkë me kryetarin e Pejës tanimë e kanë një qasje se si do ta rimëkëmbin ekonominë.



## Pasojat e koronavirusit tek industria e turizmit në Shqipëri

TIRANË, 21 QERSHOR - Turizmi është një nga sektorët më të goditur në Shqipëri nga pandemia e Covid-19. Përfaqësues të operatorëve turistikë thonë se kriza në sektorin e turizmit pritet të shtrihet gjatë të gjithë vitit dhe se kërkohet mbështetje nga institucionet shtetërore për të shpëtuar të ardhmen e këtij sektori të rëndësishëm për ekonominë e vendit. "Pandemia ndikoi shumë në të gjithë sektorët, por tek operatorët turistikë krijoi një situatë pothuajse kolapsi. Komplet sektori turistik, jo vetëm operatorët, por edhe transporti turistik, zinxhiri i hotelierisë, i gjithë sektori që është pas turizmit, është në nivel zero dhe, më e keqja është se, nuk po dimë kur do të ketë një riaktivizim, kur do të fillojmë të marrim pak frymë, kur do të shikojmë një dritë në fund të

tunelit", ka thënë përfaqësuesi i Shoqatës së Operatorëve Turistikë në Shqipëri, Sokol Hoxha për "Zërin e Amerikës".

Ai ka shtuar se ditët e fundit ka sinjale pozitive për një rifillim të ngadaltë të tureve turistike nga vende të ndryshme, por ai shton se është e nevojshme që komunitetet lokale të ndërjegjësohen për zbatimin e masave anti-Covid si një kusht i domosdoshëm për të krijuar siguri për turistët që vizitojnë vendin. "Kanë filluar disa bjellorusë, po fillojnë ukrainasit, polakët janë të gatshëm për të rifilluar. Ndoshta nga gjysma e korrikut dhe gushtit mund të shtohet turizmi, të paktën jo për grupe turistike të mëdha, por të paktën për hotelierinë. Gjithsesi shpresojmë. Por është edhe diçka që ka të bëjë me natyrën e vendit tonë. Ne shquhemi ndër njerëzit



që nuk respektojmë masat dhe, me këtë, ne vetëm vetes i bëjmë dëm", ka thënë Hoxha.

Goditja që ka pësuar sektori i turizmit në Shqipëri nga pandemia dhe masat e forta, që shoqëruan prej gati katër muaj gjendjen e fatkeqësisë natyrore

Covid-19, pritet të ndihen përgjatë gjithë këtij viti e, ndoshta, edhe më tej. Ndaj operatorët turistikë ndiejnë nevojën e mbështetjes nga shteti. "Të gjithë duhet të jenë të pajtimit për ta ndihmuar sektorin e turizmit, hotelet dhe operatorët turistikë. Duhet minimalisht të

ulen taksat lokale. E di se shteti nuk funksionon pa taksa, po njerëzit janë në situata shumë të vështira. Po kështu është edhe situata e bankave pasi nuk ndihmohet me kredi 4 a 5 për qind. Duhet të bëjmë atë që po bëjnë vendet e rajonit për ta ndihmuar këtë sektor", ka deklaruar Hoxha.

Të dhënat në vitet e fundit dëshmojnë se turizmi është një ndër sektorët që sjell më shumë të ardhura në buxhetin e Shqipërisë, atë të sipërmarrjes dhe të familjeve shqiptare. Me një kontribut në prodhimin e brendshëm bruto prej 8.5 përqindësh dhe një tregues prej më shumë se 350 mijë të punësuarish, këtë vit, për shkak të pandemisë, sektori i turizmit pritet të pësojë rënie të ndjeshme duke ndikuar në të gjithë ekonominë e vendit.



# A po dështon Kosova ta përfitojë ndihmën financiare ndërkombëtare?



Bujar Tërstona (RFE/RL)

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Vonesat që po krijohen në ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare do të mund ta pamundësojnë tejkalimin e problemeve ekonomike dhe sociale që u krijuan nga pandemia Covid-19, thonë ekspertë të ekonomisë dhe përfaqësues të autoriteteve në Kosovë. Sipas tyre, Kosova po futet në një krizë të thellë ekonomike të shkaktuar nga masat që u morën për ta frenuar përhapjen e koronavirusit nëse nuk do të mund të arrijë t'i fusë në funksion këto fonde që dalin nga ratifikimi i këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare.

Për përballimin me situatën shëndetësore dhe ekonomike, të shkaktuar nga përhapja e sëmundjes Covid-19 që shkaktohet nga koronavirusi, sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, janë pesë marrëveshje në vlerë prej 253 milionë eurosh.

Në seancën e kaluar më 11 qershor, Kuvendi i Kosovës nuk arriti ta sigurojë numrin e mjaftueshëm të votave për, prej 2/3 të deputetëve të pranishëm, për miratimin e projektligjeve për ratifikimin e pesë marrëveshjeve ndërkombëtare.

Partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës, nuk dhanë mbështetjen e tyre për ratifikimin e këtyre marrëveshjeve.

Përfaqësuesit e Vetëvendosjes thanë se do të përmbahen gjatë votimit të këtyre marrëveshjeve, ndërkaq shefi i grupit

parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, gjatë seancës tha se marrëveshjet janë arritur që një kohë dhe, sipas tij, ka pasur "nguti" me sjelljen e tyre në kuvend, prandaj edhe kanë thënë se nuk do t'i votojnë ato.

Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka caktuar seancë më 23 qershor, në të cilën pritet të shqyrtohen edhe një herë këto marrëveshje ndërkombëtare. Marrëveshjet ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Kosovës, sipas Kushtetutës, duhet të ratifikohen në Kuvend me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve.

## Krasniqi: Mosratifikimi i marrëveshjeve vë në rrezik ekonominë e vendit

Zëvendësministri i Financave në Qeverinë e Kosovës, Agim Krasniqi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se mosratifikimi i këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare do të vë në rrezik rimëkëmbjen ekonomike të vendit. "Rëndësia e ratifikimit të këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare financiare është i madh. Edhe projeksionet e buxhetit për vitin 2021, përveç financimit të brendshëm, mbështeten në fondet e këtyre marrëveshjeve. Në rast se këto marrëveshje nuk ratifikohen, nuk ecim

përpara duhet t'i rikthehemi rishikimit të buxhetit dhe kjo sjell probleme të jashtëzakonshme", thotë Krasniqi.

Krasniqi shton se të gjitha proceset do të vonohen, edhe programi i qeverisë që përfshin programin për rimëkëmbje ekonomike, në shumë pjesë të planifikimit nuk mund të ekzekutohen. Marrëveshjet për kredi të cilat kërkojnë ratifikim në kuvend nuk kanë të bëjnë vetëm me situatën e krijuar nga pandemia Covid-19, por janë edhe marrëveshje të tjera për projekte që kanë të bëjnë me trajtimin e ujërave të zeza.

## Kosova po vonohet në rimëkëmbjen ekonomike

Eksperti i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se është shqetësues mosratifikimi i këtyre marrëveshjeve pasi që këto mjete financiare të këtyre marrëveshjeve janë të domosdoshme për rimëkëmbje ekonomike. "Një ndër indikatorët më shqetësues është mosuniteti politik dhe tentativat që më shumë të mbrohen interesat e partive politike sesa interesat e shtetit. Në këtë drejtim jemi dëshmitarë të një realiteti të hidhur të krijuar, ku shumë marrëveshje ndërkombëtare nuk janë ratifikuar dhe në momentin kur Kosova ka më së shumti nevojë për asistencë

financiare nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë, kemi mbetur peng i marrëveshjeve të paratifikuara", thotë Gërxhaliu.

## BE-ja e zhgënjyer nga mosratifikimi i këtyre marrëveshjeve

Mosmiratimi i projektligjeve për ratifikimin e pesë marrëveshjeve ndërkombëtare në seancën e kaluar të Kuvendit të Kosovës ka nxitur reagimin e ambasadorit të Gjermanisë në Prishtinë, Christian Heldt. Heldt pati kritikuar Kuvendin e Kosovës për këtë gjë. "Fjala zhgënjim është shumë diplomatike. A do ta shohim së shpejti Kuvendin e Kosovës duke punuar? Kjo kishte të bënte me paketat e ndihmës për shtetin dhe popullin", pati shkruar Heldt në një postim në rrjetin social "Twitter". Ai i ka bërë këto komente, ndërkohë që edhe shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Nataliya Apostolova, ishte shprehur "e zhgënjyer" që Kuvendi nuk ka miratuar këto legjislacione. Mekanizmat financiarë ndërkombëtarë në raportet e tyre të publikuar për efektet e pandemisë në ekonominë e Kosovës, kanë vlerësuar se janë shkaktuar dëme të mëdha. Banka Botërore në raportin e saj ka paraparë një rënie ekonomike prej 4,5 përqindësh në Kosovë.

## S'ka fluturime në ANP 'Adem Jashari' deri më 27 qershor

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) "Adem Jashari" ka bërë me dije se deri më 27 qershor do të ketë ndalesa për trafikun ajror në këtë aeroport. "Sipas njoftimit të ri të autoriteteve relevante

shtetërore, ju njoftojmë se trafiku ajror akoma mbetet në gjendjen e njëjtë me ndalesë deri më 27 qershor 2020, me mundësi ndryshimi në çdo kohë për vazhdim apo largim të ndalesës", ka njoftuar ANP-ja.

Sipas këtij njoftimi, Qeveria e Kosovës është autoritetja përkatese e cila vendos për datën e lejimit të të gjitha fluturimeve si në ardhje, po ashtu edhe në nisje. "Andaj ju lusim t'i adresoni pyetjet/kërkesat si dhe

shqetësimet tuaja në adresë të tyre dhe jo te ne. Ritheksojmë se Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari'-LKIA është i gatshëm të procesojë të gjitha fluturimet si në ardhje, po ashtu edhe në nisje me të gjitha kapacitetet e plota. Ne,

bashkë me ju, jemi në pritje të lejimit të funksionimit të plotë të fluturimeve për/në ANP 'Adem Jashari', prandaj kërkojmë mirëkuptimin tuaj deri në informacionin e ardhshëm", ka njoftuar ANP "Adem Jashari".

## Haziri nderon me mirënjohje doktorët e pensionuar dhe katër veprimtarë të çështjes kombëtare

GJILAN, 21 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në kuadër të shënimit të 21-vjetorit të çlirimit të Gjilanit, ka nderuar me mirënjohje mjekë dhe veprimtarë për kontributin profesional dhe patriotik për të mirën e përgjithshme.

Mjekët që janë nderuar me mirënjohje për kontribut profesional janë: Elmaze Hyseni, Hysen Sherifi, Ymer Elezi, Bejtush Zylfiu, Semahate Kurteshi, Haqif Huruglica, Maxhide Shaqiri, Shyhrete Islami Sahiti, Fetie Huruglica dhe Rukie Selishta. Me këtë rast, Haziri ka nderuar me mirënjohje

post mortem edhe veprimtarët e çështjes kombëtare: Gani Hajrullahu, Taip Arifi, Dalip Foniqi dhe Ibrahim Seferi. Po ashtu, Haziri e ka shpallur personalitetin e vitit Agon Musliun, i cili javë më parë humbi jetën tragjikisht në Qendrën e Studentëve në Prishtinë. "Qëllimi është që njerëzve profesionistë të fushave dhe veprimtarëve t'u themi fale-minderit për punën e madhe që kanë bërë për të mirën e përgjithshme", ka thënë kryetari Haziri.

Ai ka kërkuar zbardhjen e rastit të Agon Musliut në mënyrë që shpirti i tij të pushojë në paqe.



## Prizrenit i shtohet edhe një destinacion i turizmit malor

PRIZREN, 21 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, së bashku me nënkryetaren për komunitete, Memnuna Ajdini dhe drejtore-shën e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sevil Kazaz,

kanë përfunduar hapësirën e re për piknik në afërsi të fshatit Jabllanicë të kësaj komune.

Me investimet e realizuara nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kjo hapësirë është rregulluar me

ulëse, tavolina, strehë, çezme, kënd të lojërave për fëmijë dhe shtim të hapësirave gjelbëruese me fidanë të rinj. Me anë të këtij projekti qytetit të Prizrenit i shtohet edhe një destinacion i ri në kuadër të turizmit malor.

## Trajtohen rreth 4 000 gjedhe kundër rriqrave në Ferizaj

FERIZAJ, 21 QERSHOR (ER) - Komuna e Ferizajt ka njoftuar se janë trajtuar 3 800 gjedhe në këtë komunë kundër rriqrave. "Kujdesi për veprimtarinë e fermerëve, përkatësisht kafshëve që kultivojnë, po dëshmohet vazhdueshëm. Projekti për repelimin e gjedheve që u përfundua këto ditë, siguron mbrojtjen e gjedheve nga rriqrat si bartëse

të një numri sëmundjesh virale e bakteriale, që në të kaluarën solli shumë ngordhje të kafshëve në fermat komerciale dhe gjysmëkomerciale", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.

Për të inspektuar këtë aksion të rëndësishëm për fermerët dhe kafshët që kanë në përkujdesje, ka dalë drejtori i Bujqësisë e Pylltarisë, Burim

Bajrami. Pasi është shprehur i kënaqur me këtë aksion, ai ka thënë se nisma të tilla do të realizohen edhe në vitet në vijim si veprime konkrete në mbrojtje të shëndetit të kafshëve dhe ndihmë për fermerët. Bajrami ka thënë se realizimi i këtij projekti ndikon jo vetëm në shëndetin e kafshëve, por edhe në shëndetin publik.

## Prishtina organizon aksionin pesëditor për grumbullimin e mbeturinave

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se sot (e hënë) do të nisë aksioni pranveror për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme në kryeqytet. Ai ka thënë se ky aksion do të vazhdojë deri më 26 qershor dhe do të zhvillohet në pesë zona të Prishtinës. "Në kuadër të politikave për një qytet sa më të pastër, Komuna e Prishtinës përmes kompanisë së kontraktuar 'Pastrimi' organizon aksion-

in pranveror për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme si: orendi, shtretër druri ose metali, dollapë druri ose metali, tavolina druri ose metali, pajisje të kuzhinës, gjësende të tjera shtëpiake nga druri dhe metali. Aksioni do të zhvillohet pesë ditë, në pesë zona të ndryshme të qytetit, nga 22-26 qershori. Qytetarët obligohen që në lagjet e caktuara, sipas datave, t'i vendosin mbeturinat para shtëpive të tyre", ka njoftuar Ahmeti.

### AKSION PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE TË VËLLIMSHME

22.06.2020 - 26.06.2020

5 ditë, 5 zona të ndryshme të qytetit, si në vijim:

E Hënë 22.06.2020	Lagjia e Spitalit, Mati 1, Bregu i Diellit, Matičani, Aktashi, Muhaxherët, Vellusha, Velania;
E Martë 23.06.2020	Medrese, Gjinaj, Taslixhe, Qamëria;
E Mërkurë 24.06.2020	Qendër, Dardani, Lakrishte, Ulpianë, Hajvali, Veternik;
E Enjte 25.06.2020	Kodra e Trimave;
E Premte 26.06.2020	Tophane; Arbëri, Përroi i Njelmët.

Informacionet shtesë në numrin pa pagesë:  
0800 77 123



Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (12)

# Vizioni politik i Adem Jasharit



**Bedri ISLAMI**

Ai nuk do të kthehet në vendin e tij për të bërë llafe të pabukë dhe të pafund. Kur ishte kthyer ai kishte përcaktuar që dhjetë vjet më parë përgjigjen e pyetjes, që jo një herë e kishte thënë Hamza, "A po bëhet ma laps, a po bëhet me pushkë". E kishin përcaktuar si Fis që ditën kur ishte vlarë kushëri i tyre Tahir Meha, brezi i tretë i kësaj familje që bënte luftë me Serbinë.

Vizioni i qartë politik, se lufta duhet filluar që nga vetvetja e duhet bërë në Kosovë, do të jetë ndër vendimtarët në politikën e fundshekullit të shkuar. Adem Jashari, krahas tij edhe figura të tjera madhore si Zahir Pajaziti, do ta kishin meritën e jashtëzakonshme, të papërsëritshme do të thosha që pasi përcaktuan qartësisht vizionin e tyre, u bënë njëkohësisht edhe mishërues të këtij vizioni.

Në librin e shenjtë kristian, Biblën, është edhe thënia e njohur e Jesus Krishtit, se "nuk mund të jesh profet në vendlindjen tënde". Shembulli i Adem Jasharit dëshmoi se mund të ndodhte edhe ndryshe. Mund të ishte profet edhe aty ku kishe lindur. Kjo do të ndodhte nëse nuk do të shkëputesh kurrë nga vendi yt, nëse nuk do t'i humbisje ato lidhje të veçanta që të mbajnë fuqishëm pas saj.

Kjo nuk do të thotë se duke qenë vetë jashtëzakonisht i lidhur me tokën ai do të kishte përbuzje ose largesë ndaj atyre që ishin jashtë. Strukturat ilegale që ishin jashtë Kosovës, disa tepër të rëndësishme, si sektori i veçantë pranë Lëvizjes Popullore të Kosovës, apo të tjera do të kishin përherë mbështetjen e tij. Këtë e dëshmojnë letrat që ka dërguar apo porositë që ka dhënë. Edhe në letrën e tij të fundit, dhjetor 1997, është e pranishme një gjë e tillë. Është ndoshta i njëjti mesazh që do të niste nga salla e gjyqit Ukshin Hoti, kur, i pranguar, në prag të burgosjes së gjatë, do t'i dërgonte përshëndetjet e tij shokëve të lëvizjeve ilegale jashtë Kosovës.

Ideja e Adem Jasharit për të gjetur mbështetje te njerëzit e tij, në tokën e të parëve, është tejet e lashtë, ajo është një ide prometheiane. Mirëpo, aq sa është e lashtë, aq është edhe e rrallë në shfaqjen e saj në historinë e kombeve. Ne jemi fatlumë që kishim një Njeri, i cili, në fundin e shekullit të njëzet, e risolli këtë ide te ne, në formën

më të mrekullueshme të shfaqur dhe, njëkohësisht, në formën më të heshtur. Është ndër rastet e rralla, kur e madhërisht shfaqet krejtësisht e heshtur.

Vizioni politik i Adem Jasharit shkonte përtej asaj që mund të quhej fusha e tij e veprimit. Që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore dhe deri në fillimet e viteve '90, qëndresa kundër pushtimit serb do të kishte disa shembëllyra, herë më të spikatura e herë më të zbehta por, sidoqoftë, thuajse në çdo dhjetë vjet ka pasur një ngritje masive. Kjo ka qenë e rëndësishme, pasi asnjëri brez nuk mund të quhet brez i humbur, pavarësisht se u bënë investime të mëdha për të pasur jo një, por disa breza të tillë.

Lëvizjet kryengritëse të shqiptarëve në Kosovë deri në shfaqjen madhore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishin qenë në konturet e kufijve të shqiptarëve jashtë Shqipërisë. Megjithëse e kishin ditur se në rastet e hallevë të mëdha mund të mbështeteshin te shteti amë, gjithçka që ishte rrokullisur në pesëdhjetë vjetët e fundit, e bënë të vështirë shkuarjen më tej se dëshira apo ideja.

Adem Jashari do të krijonte, fillimisht në kujtesën e vet, e pastaj në konfiguracionin politik të strukturave të luftës, idenë e saktë se lufta do të mund të fitohej, nëse shteti amë do të ishte streha e dytë e luftës.

Është i njëjti mendim politik i shfaqur në të gjitha veprat e Ukshin Hotit. As njëri dhe as tjetri, megjithëse ishte koha kur mbi Shqipërinë hidheshin gurët e mëdhenj të sharjeve, nuk e mohojnë atë, nuk e shohin si njerë, por si nënë dhe e trajtojnë si të tillë. Me mijëra e qindra mijëra artikuj do të shkruheshin në shtypin udbash kundër Shqipërisë, asnjëri prej tyre nuk do të bënte vend në mendimin e Adem Jasharit. Për të bërë sa më të qartë këtë vizion brenda vetes, ai rikrijon mitin e Çerçiz Topullit dhe bashkë me të vëllanë, Hamzën, mitin e Mihal Gramenos.

Ai mund të ngrinte brenda vetes një mit tjetër. Kishte mjaft të tillë, mirëpo ai e kërkon deri atje ku mendon se mund të jetë shembulli më i skajshëm, në Gjirokastër dhe ku është edhe njëkohësisht më domethënëse: një toskë, luftëtar i vrarë nga sllavët në daljen buzë liqenit të Shkodrës.

Disa vite pas ngjarjes së njohur, Murat Jashari, nipi i Hamzës dhe i Ademit, për një ekip kineastësh nga Shqipëria, do të thoshte se "shpirtrat rilindin. Shikojeni filmin e Çerçiz Topullit, ngjarjet dhe figurat që kanë lëvizur në atë film dhe në pozicione të ngjashme është gjetur Adem Jashari me shokët gjatë luftës. E njëjta ngjarje ka ndodhur, e njëjta

luftë. Çerçizi ka pasur pak fjalë. Edhe Ademi ka folur shumë pak. Anën diplomatike në filmin e Çerçiz Topullit e ka udhëhequr Mihal Grameno. Atë rol, ndërkaq, tek ne e ka pasur Baci Hamzë...". E vërteta është edhe më e gjerë se kaq. Mirëpo nipit të Jasharëve, në modestinë e tij, i takonte vetëm kaq të thoshte. Mirëpo, ajo që ishte themelore dhe që ka mbetur ende në kujtesën e të gjithëve është pikërisht miti që ngriti Adem Jashari, jo thjeshtë se nuk mund të ngrinte një mit tjetër, por sepse e kishte të qartë tashmë se njerëzve u duhej ideja e luftës së përbashkët, jo vetëm përmes gjërave të zakonshme, por edhe përmes miteve.



Në ditët e netët e luftës së njohur të 5, 6 dhe 7 marsit, Adem Jashari do t'i kthehej edhe një herë mitit të tij: gjatë gjithë kohës ai do ta këndonte këngën e njohur të Çerçiz Topullit. Do ta përsëriste dhe e ripërsëriste, do ta kthente në thirrje e forcë dhe, më pas, pak kohë pas përfundimit të luftës, Besarta, e vetmja mbesë e fisit që mbijetoi, do të thoshte se "sa kam dëgjuar bacin Adem që këndonte, hiç nuk kam pasë frikë...".

Vizioni i Adem Jasharit, se lufta duhej kaluar përmes të gjithë kombit, do të ishte më se i saktë dhe jetik. Ai në shumë raste do të ishte ndër faktorët më përcaktues dhe njeriu i heshtur, Adem Jashari e kishte ditur dhe e kishte paraprirë këtë. Ukshin Hoti do ta përcaktonte me veprën e tij, Adem Jashari, do ta mishëronte me jetën e tij. Megjithatë, nuk janë vetëm këto. Këta ishin dy gurët e mëdhenj që ai ngriti, me forcën e një titani, në rrugën që donte të bënte, por kjo do të ishte, po ashtu, e pamjaftueshme.

Ai eci edhe më tej...

Adem Jashari nuk do të ngutej. E kishte të qartë se asgjë nuk do të vinte për së mbari nga grykat e

Velanisë, por as nuk i bëhej merak për këtë. Po të ishte puna që të pyeteshin "institucionet" e Kosovës, as për njëqind vjet nuk do të kishte filluar qëndresa e armatosur për të shkuar drejt luftës së pashmangshme. 30 dhjetori i vitit 1991 do të ishte fillesa e pagëzimit të parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nëse do të kishim pasur ngutje, nëse njeriu mit do të kishte menduar se "hajt, po ia fillojmë", do të kishte qenë lehtësisht e mundshme që çdo gjë do të ishte shkatërruar e rrënuar, ani pse njeriu që do të kishte filluar, do të kishte mbetur në histori.

Në vitin 1993, në një fjalim publik, me rastin e varrosjes së dy dëshmorëve, Ukshin Hoti, vizionar dhe njëkohësisht dinjitoz si ai, do të thoshte krejt hapur se "Kosovës i duhet ushtria e saj çlirimtare". Do të ishte e njëjta gjë që do të sendërtonte Adem Jashari, pasi e kishte kërkuar atë, pasi kishte punuar për ta pasur atë. Mendimi vizionar, i thënë krejt shkurt nga Adem Jashari, po ashtu krejt saktë se "armët nuk i kam marrë për t'ia dorëzuar Serbisë, por që ta bëj luftën kundër saj", është krejt i njëjtë me përjasjen filozofike të Ukshin Hotit, për domosdoshmërinë e krijimit në Kosovë të ushtrisë së saj çlirimtare.

Vizioni politik i Adem Jasharit është i mbështjellë me konfigurimin e armës, ndërsa ka në thellësinë e vet mendimin e qartë se lufta ishte e domosdoshme, pasi nuk do të kishte rrugë tjetër dhe, së dyti, kjo luftë nuk duhet bërë, ashtu kaçakçe, si kishte ndodhur jo rrallë në historinë e kombit tonë. Ai kërkonte që të luftohej. Kjo luftë, nëse do të ishte e domosdoshme, do të fillohej nga vatra e tij, për të shkuar më tej në të gjithë Kosovën. Por jo një luftë e ngulitur thjesht në një mal, me njerëz që qesin pushkë thjesht se nuk e duan pushtimin dhe Serbinë, me njerëz të cilëve u ka ardhur deri në fyt e keqja e pushtimit. Ai kërkonte shumë më tepër se kaq dhe, për të ngritur një gjë të tillë, ai kishte aftësinë që të priste, të ecte në drejtvizimin e duhur, të mos ngutej dhe të mos krijonte rreth vetes një rreth të mbyllur.

Më shumë se gjithçka kjo do të ishte një luftë politike dhe kjo kërkonte një drejtim politik. Për të ardhur deri në mesin e vitit 1993, kur edhe zyrtarizohet prania e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të kishin kaluar disa vite. Në fillimet e vitit 1989 dhe më pas, Adem Jashari do të ishte një ndër anëtarët e strukturave ilegale që do ta kërkonin ngritjen e ushtrisë së shqiptarëve të Kosovës. Në bisedë me Ramadan Avdiun, asokohe një ndër drejtuesit kryesorë të Lëvizjes Popullore të Kosovës, Grupi i Drenicës, mes të

cilëve spikaste roli dhe figura e Adem Jasharit, do të thoshte qartësisht: "Ne jemi të gatshëm të bëjmë edhe nga një aksion në javë, por dikush duhet t'u dalë zot aksioneve tona. Jo vetëm t'i mbështesë, por edhe të ketë përfaqësimin politik, mbështetjen politike".

Kjo do të ndodhte për herë të parë pas shumë e shumë viteve. Deri atëherë lëvizjet spontane apo të organizuara të qëndresës shqiptare në Kosovë nuk e kishin pasur këtë element thelbësor, tani forcat politike ilegale e kërkonin këtë, ndoshta edhe duke pasur parasysh përvojat e deriatëhershme. Adem Jashari do të ishte një nga të parët që do ta kërkonte këtë si forcë madhore për ta krijuar qëndresën e armatosur dhe luftën deri në fitore.

Sado thellë që të futesh në jetën dhe rrugëtimin e këtij njeriu nuk do të gesh dot asnjë rast të vetëm, qoftë edhe krejt minor, në të cilin ai do të kërkonte të shfaqej si figurë kryesore. Fjalëpakë si rrallëkush, ai do të bëhej edhe më i heshtur kur do të ishte fjala për rolin e tij. Në mënyrë këmbëngulëse ai nuk e kërkoj asnjëherë krijimin e figurës së tij si prijës apo lider, gjithçka ndodhi mrekullisht vetë, pa asnjë dekret dhe fjalë.

A kishte pasur rast kur ai do të shfaqej haptas si njeri themelor i luftës që po vinte? Sigurisht që ka disa të tillë.

Është i njohur fakti se rrethimi i parë i kullave të Jasharëve ndodhi më 30 dhjetor të vitit 1991. Në shtëpi ishin të tre djemtë: Rifati, Hamza dhe Ademi. Ishte i ati i tyre, baca Shaban, ishin pjesëtarët e tjerë. Rrethimi kishte filluar që në orët e vona të mbrëmjes dhe, si do të dëshmonin më vonë pjesëtarët e familjes Jashari, ka qenë i pritur prej tyre. Ishte piku i dimrit, ftohtë i jashtëzakonshëm, gjithkrah ishte mbuluar nga dëborë. Tre burrat e familjes Jashari, pas përqeshjeve të forta, do të çajnë rrethimin dhe do të dalin në kahe të ndryshme, nga të ndezin edhe një herë zjarrin e luftës. Policia merr peng 27 anëtarët e familjes Jashari, ndërsa të gjithë meshkujt, prej Fitimit e lart, pra ata që i kishin mbi 13 vjet, i nxjerrin me duar të lidhura, në borë, para tankut.

Policët e nxjerrin edhe nënën e Jasharëve si mburojë përpara, duke dashur të hyjnë në shtëpi, gjithnjë me mendimin se Ademi ishte brenda. Ndërkohë Grupi i Drenicës ishte mbledhur. Me orët që shkonin kanë filluar të shkojnë në ndihmë të Jasharëve njerëz të armatosur nga Prekazi, nga të gjitha anët e Drenicës, por edhe me gjerë se kaq. Mali përballë kullave është mbushur me njerëz. Secili e kishte nga një armë me vete. Janë mbledhur për të gjykuar dhe u kanë thënë Jasharëve "Merrni komandën dhe udhëhiqeni luftën". (Vijon)

# Cikël poetik nga Valbona Rexhepi-Hadri

## Malli për nënën time

Ti frymëmarrja ime, nënë Shpirtin ma ngrohë dashuri, Të paça dritë, yje, qiellit tim Nënë e hënë mrekullia ime.

Ti sot larg meje frymon. Unë s'të kam pranë të të puth. Për të arritur te ti nënë, Duhet kaluar det e oqean.

Mbyll sytë për një çast nga dëshira e zjarrtë të të kam pranë. Ti nënë e syrgjynosur larg meje Nxjerr lotin tim nga qepallat e lagura nga një lot i bijës sate në përçafimin tënd.

Ti me afshin e zjarrtë amësi ëmbëlake. Dëgjoji rrahjet e zemrës së bijës sate. Më fal një buzëqeshje të bukuar nënë, ta shuaj mallin tim që fle në shpirtin tënd.

## Kumbulla që e mbollëm bashkë

Erdha të flisja me ty, baba Të tregoj se kumbulla kishte shtuar shtat. Kishte edhe fryte goxha shumë, por jo aq sa librat e ndaluarra që m'i lexoje dikur. Kam shumë nostalgji për zërin tënd, sepse vetmia më bën të shurdhur pa ty.

Më mungon fjala e jote, prehri yt, baba Më mungon fëmijëria ime dhe mësimet tua për historinë e popullit tim.

Ka shumë vite, ishte tjetër botë në të arrirë muzgu ti merrje librin e dijës. Akoma pa lind dielli shfletojë histori në sytë e mi. Pastaj fshehje fletët nga pushtat e zi që sillëshin vërdallë lagjes së përgjakur.

Isha fëmijë, baba nuk kuptoja, përse s'kishim të drejtë të lexonim në pikë dite pa frikë nga terrina.

Pastaj më mësove dhe më fole për dritën e agmisë në të ardhur. Më tregove edhe për librat e ndaluar, ngujuar në fuqinë e turshive nën dheun dardan.

Ajo fuçi tashmë është e zbrazur dhe librat nusërojnë nëpër bibliotekat tona, së bashku me shpatën e Gjergjit tonë.

Nën kapakun e vetmisë, e njoha Ismail Qemal - beun dhe Vëllezërit Frashëri. U rrita me poezitë e Naimit, Samiut, Asdrenit, Çajupit, Nga Migjeni mësova për mjerimin e një kohe të vranë.

Me ndjenjën e dhimbjes mësova poezitë e arbëreshëve. Mësova edhe për Serembën dhe fatin e tij në çmendinë e Sao Paolos. Mësova edhe për De Radën dhe Këngët e Milosaos Pastaj shfletova edhe fjalët nga Filip Shiroka dhe nga Gavriil Darë.

Sot e përlotur nën shushurimë gjethesh dëgjoj këngën e bilbilit të harruar në degë kumbulle. Duke prekur nëpër ballin e kujtimeve tua, baba shikoj kumbullën që e mbollëm bashkë. Ka goxha fryte, baba i dashur dhe më japin fresk qepallave të lagura lotësh.

Në trupin e kësaj peme shoh hijen tënd, baba Por assesi t'i qetësoj të rrahurat e zemrës Mungesa jote baba, më bën të ligem nga dashuria për ty.

Desha të flisja me Ty, të tregoja për pjesën e mbetur pas ikjes tënde, por nuk dua të flas pa buzëqeshjen e babait.

Unë do të mbetëm me të njëjtin mall nën fletët e kumbullës që e mbollëm bashkë pemës që rritet nga rrënjët e librit tënd.

## Hënë e diell

Shikoj nën degë lisi, gravuar në qiellin e kaltër hënë e zbehtë praruar me treze dielli.

Ëmbëlsisht ndiej gjallërinë e ditës së veshur beharore në tretjen e gëzimit të diellit përballë hënës lozonjare.

Shkëlqimi i tij rrezartë kishe kapluar madhërisht përçafimin e saj në mëngjesin e bukur muajit të qer-shive.

Pasioni i dashurisë diell - hënor, ringjalli ndjesinë e buzëqeshjes moti të harruar.

## Seç tha trimi sypatrembur

Në ballë të brigadës me këngë burrash bashkë me shokë të një gjaku të një fisi zgjatën zërin ngjiten qiellin e kushtimit.

I urtë, i qetë, burrë fisnik i sinqertë, I vendosur të japë jetë, nxjerrë gjashorën i jep përplotë.

Në mbrojtje të atdheut do të eshtrat, sepse duhet vdekur të mos vdesë dot, toka e të parëve nuk mposhtet kurrë gjaku im do të pikojë sy shkabe mbi flamur.

Me diplomaci e pyeten të huajt nën sy: për kë lufton o trim o burrë dai? Me urtësi u tha trimi: për Nënë Shqipëri.

Përse pra nuk shkon në Shqipëri? - i thanë të huajt prapë nën sy. Burri lëvizi qemerët e vetullave dhe ua derdhi në sy: në Shqipëri jam ore zotërinj, në atë që ju e cunguat me sëpatë. Është një komb i ndarë në dysh, çare s'kam pa e bërë njësh.

Të një zëri me një mendje, burrat lidhën fjalët shtrënguan brezat.

Kosovë o Nënë Shqipëri, të urojmë Preshevën me gjithë Çamëri!



# Cikël poetik nga Valbona Rexhepi-Hadri

## Lulja ime

Trëndafilja ime aromë parajsore Shndrit si hënë përtej oqeanit Si gjithmonë në sytë e mamit Bukuri ëmbëlake fytyrë engjëjlore.

Shkëlqimi yt mbi kurorë mbretërore Të veshi me petkun e gjethit të artë Me mall gëzimi mbete lumturia ime Kënaqësinë tënde e shijojmë nga larg.

Në tokën e bukuar ku mbolle rrënjët arbërore u bekove për të vazhduar prorë.

Udhëtimi yt nuk ishte i lehtë mbi supe Ishe ende lule në rrugën qumështore Ngjite qiellin pikën ku doje të shkoje.

Pra, bija ime këngë e kënduar prorë Qëndro e bukur kokëllartë rrah krahët Je shembull për ta marrë rrugën tënde Kthehu në kopshtin tënd trëndafilja ime.

Pra, bija ime këngë e kënduar prorë Kthehu pranverë e gëzuar lule mbi ty.

## Ishe ti

Të ulur pranë lumit me emrin tim Nën hijen e lisit të thinjur kohësh Shijonim cicërimat e zogjve të malit. Ma mbaje dorën fort Duke rëfyer një ngjarje të bukur E tretur në ndjesinë e të përjetuarit kërkvoja mbështetjen e gjoksit tënd.

Kthjelltësia e syve t'u të puthur depërtoi thellë në shpirtin tim. Do vdisja me një brengë në shpirt, pa e kuptuar kurrë dashurinë, po të mos isha me ty Më the duke më përkëdhelur flokun e artë të derdhur mbi supe.

Symbyllur tretësia në butësinë e mëndafshhtë të fantazisë përallore Ku valët lumore më ndërmendnin se ndjenja e magjisë ekziston vetëm për ty.

Vura dorën e hapur në zemrën tënde duke ndier tik-taket e shpejtuaara sikur Ti doje te ikje por në dorë më le një copëz ar të gravuar me emrin tim. Ti je në mua - më the sy më sy dhe u nise. S'të arrija dot, ishe më i shpejtë se era. Të telefonova, më kishte humbur sinjali.

Mbeta e vetmuar në muzgun e mbrëmjes me perëndim dielli E raskapitur në kërkim të hijes tënde, lëshova një ofshamë zemre të vranë Një drithërimë rrëqethëse deri në palcë Më zverdhi lëkurën bardhoshe.

Me sëmbime gjokseve u zgjova E raskapitur nga ëndrra me pamjen tënde.

## Në pritje

Përballë hënës së plotë këmishës së valës së detit shenjëzohet ndjesia e dashurisë në zemrën e djaloshit.

Dashuria për të bukurën ngjallë shpirtin e tij prej krijuesi për t'i vargëzuar fjalët e veshura në ar çdo fjalë që përmbushë gjallërinë e tij.

Vrapimi i tij pas shëmbëllimit hirplotë zbukuruar me hijeshitë e luleve të verës qëndisur në fustanin e saj zgjoi magjinë e këngës me jehonë jete.

I lutej kaltërsisë qiellore gjelbërimit të fushës së virgjër cicërimës së zogjve ua vë veshin nëpër shushurimën e gjetheve pret Valën e lumit t'i nxjerrë krahët me rrezet e diellit për t'iu bashkuar këngës së tij në shuarjen e mallit për të bukurën.

Ajo i shfaqej kudo dhe në ëndërr me imazhin e syçkave të saj plot zjarr Ajo do të nxjerrë në pah betiminin e tij për t'ia thënë të shkruar se ishte e vetmja dashuri.

## Ndjenjë amësie

Ndjenjë që prekë qiellin me dashuri Sundon botën dhe tërbimin e detit Që fal shpirt njeriu dhe jep bekimin Ëmbëlsisht mbështjellë vajin e fëmijës Rrotullon botën në krahë për së mbari Që fal gjallëri dhe pafundësi shpirti Nuk zëvendësohet me asnjë frymë tjetër Të jep prehrin e nënës dhe rritë të mbarë Si asgjë tjetër në botë rritë flokun mbi sy.

## Loti në syrin e së bukurës

Erdhi e pastër si lot fëmijë, e bukur si gjithnjë fluturake, fytyrë ëmbëlake, buzëqeshje e hapur dalë nga ngrohtësia e rrezeve deportuar nga këndi i vendqëndrimit të saj.

Rrjeti valëzues lozonjar ndiqte lëvizjet e vargëzuara në pejza margaritarësh.

Shpirtbardhësia e saj prej virgjëreshe, shoqërohej me kthjelltësinë e ndjenjave, dhimbjen e nxirrte nga shkëlqimi i syrit, me fjalë mashtronte burimin e lotit të saj.

Pamja kristalore e një loti rrotullohej duke ngarendur deri te buza e skuqur ku gdhendej mjeshhtëria e fjalës së thënë nga thellësia e mallëngjimit. Një rrëfim që shponte zemrën përtej brishtësisë së një shpirti të artë si diell.

Përse të shihet loti në syrin e së bukurës?

A thua vallë nga paragjykimet duhet të përbuzet bekimi i Perëndisë?

Kot shkëlqimi i saj ndrinte si hënë. Ishte nur për njerëzimin reth saj. Bukuri veçane që ngjante me pranverën.

Vazhdo dhe ec rugëtimi yt u mbuloftë me të bardhën dritë, shkëlqimi i syrit tënd u praroftë me dashuri!

**E jashtëzakonshme**

**Indiani që i lejon 60 mijë bletët t'ia mbulojnë fytyrën**

Një djalë nga India, i cili mban bletë, thotë se u beson aq shumë insekteve që i konsideron miq, sa që mbi 60 mijë sosh i lejon t'ia mbulojnë fytyrën. 24-vjeçari i njohur si Nature M. S. iu referohet bletëve si "miqtë më të mirë", duke besuar se ato nuk e konsiderojnë atë si kërcënim.



**BARSOLETA E DITËS**




**Gjakovari**

**Djali: Babi, mamën e zuri rryma. Baba: A është me të lirën a me të shtrenjtën?**



**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

**FOTO E DITES**



Një dele shihet duke kullotur, ndërsa dy fëmijët qëndrojnë afër saj duke shikuar në majën e një mali në periferi të Srinagarit në Indi. /AFP/

**Kënga e fuqishme e Beyonce: Diva është gati për albumin e shtatë**

Beyonce surprizoi internetin duke publikuar këngën "Black Parade", të bashkëshkruar me Jaz-Z. "Black Parade" u krijua për të mbështetur fondin Black Business Impact, që administrohet nga National Urban League dhe ka qëllim që të ndihmojë bizneset e vogla të njerëzve afro-amerikanë. The National Urban League është organizatë për të drejtat e afro-amerikanëve me qendër në Nju Jork. "Black Parade" është një përjetim personal që nis nga historia e nënës së Beyonce-s që siç këngëtarja thotë, "është edhe historia e saj gjithashtu". "Gëzuar Juneteenth Weekend! Shpresoj të gëzojmë dhe festojmë së bashku, qoftë edhe në mes të kësaj lufte," shkroi

Beyonce në YouTube. Juneteenth është manifestim që tregon emancipimin e atyre që dikur ishin skllëvër në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në YouTube, njerëzit shkruajnë se "Beyonce u rikthye me të vërtetë" dhe duket se "është gati për albumin e shtatë". Albumi i fundit i realizuar në një studio muzikore është "Lemonade" (2016) dhe nuk është çudi që Beyonce të publikojë albumin e radhës, i cili me gjasë do të përmbajë motive të fuqishme të #blacklivesmatter, lëvizja që kërkon barazi për njerëzit me ngjyrë. Kujtojmë se Beyonce reagoi publikisht pas vdekjes së George Floyd përmes një videoje ku i kërkoi njerëzve t'i bashkoheshin kësaj çështjeje.



**E rrallë**

**Copa e madhe e akullit shkëputet dhe bie në det, shkakton dallgë të mëdha në Alaska**

Një video amatore shfaq momentin kur një copë e madhe e akullit shkëputet dhe bie në det, duke shkaktuar dallgë të mëdha në Alaska. Ky moment është kapur nga një anije që po lundronte në ato momente në Seward. Copa e akullit ra nga ajsbergu Aialik që konsiderohet si një nga ajsbergët më të mëdhenj në bregun Aialik.



 <p><b>DASHI</b> Nuk do të tregoheni aq origjinal sa jeni dhe mund të rrezikoni të bëni disa gabime. Në familje mund të dalin disa çështje nga e kaluara që duhet t'i zgjidhni.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot do jetë një ditë me shumë fat dhe argëtim. Do të jeni i qeshur, miqësor, i pajisur me dialektikë që do t'ju rrisë vlerën dhe të hapë rrugë për projekte të reja.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Në vend se të vazhdoni të merreni me një mijë gjëra, ju duhet t'i renditni dhe të zgjidhni ato më të rëndësishmet.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Ditë e rëndësishme për Gaforren. Do të lini pas dembelizmin, pavendosmërinë dhe pasigurinë që keni pasur këtë kohë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Mos harroni hobin tuaj vetëm për t'i ndjekur çështjet praktike. Gjeni një mënyrë për të shpenzuar kohë për atë që ju pëlqen.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Do të shijoni një ditë të qetë, ideale për të takuar miqtë dhe për ta rinovuar pamjen tuaj në një sallon bukurie.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Instinkti dhe intuita do t'ju ndihmojnë të merrni vendime të duhura. Nëse keni probleme me kaloritë e tepërta, bëni mirë t'i nënshtroheni një diete.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Ditë e këndshme sidomos për marrëdhëniet miqësore. Nëse po udhëtoni ose po largoheni nga monotonia, përgatituni për takime të reja interesante dhe argëtuese.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Më në fund zgjedhjet tuaja do të jetë vetëm tuajat. Pra, para se ta hidhni hapin e parë, mendoni më shumë se një herë. Vlerëso dashurinë dhe personin që ju do.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Humori sot nuk do të jetë shumë i mirë, por me pak taktikë gjithçka do të zgjidhet. Përpiquni që të mos përfshihen në debate të panevojshme me partnerin tuaj.</p>	 <p><b>UJORI</b> Interesimi për një person të njohur kohët e fundit mund të shtyjë disa prej jush drejt festës dhe një aventure.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Inteligjenca, vendosmëria, gëzimi, entuziazmi dhe mendimi pozitiv janë pikat tuaja të forta. Nëse ju pëlqen gatimi, provoni një pjatë të re dhe ftoni miqtë në shtëpinë tuaj.</p>

## Princ William feston 38-vjetorin, poston fotografi me tre fëmijët



Princ William ka festuar të dielën 38-vjetorin e lindjes. Me këtë rast princi ka postuar dy fotografi mjaft të ëmbla me tre fëmijët e tij.

Fotografitë janë realizuar në ambientet e pallatit mbretëror nga Kate Middleton dhe janë shpërndarë në rrjetet sociale nga vetë ata.



## Angelina Jolie tregon arsyen e ndarjes nga Brad Pitti

Ylli i Hollivudit, Angelina Jolie, tha se ishte “vendimi i duhur” për ta përfunduar martesën e saj dyvjeçare me Brad Pittin. Në një intervistë për “Vogue India”, Jolie foli si rrallëherë për divorcin e çiftit në 2016, duke thënë se vendimi për t’u ndarë pas dy vjetësh martesë ishte bërë për “mirëqenien” e

gjashtë fëmijëve të tyre. “Unë u ndava për mirëqenien e familjes sime”, tha ajo. “Ishte vendimi i duhur. Unë vazhdoj të përqendrohem te ta”, u shpreh ajo. Dyshja u martuan në gusht të vitit 2014 në jug të Francës dhe kanë gjashtë fëmijë së bashku, tre fëmijë biologjikë dhe tre të birësuar.

## Bob Dylan nxjerr albumin e parë original në tetë vjet



Muzikanti legjendar Bob Dylan ka nxjerrë albumin e parë të këngëve origjinale në tetë vjet, të quajtur “Rough and Rowdy Ways”. Në këtë album të 39 në studio, i cili shfaqet 58 vjet pas opusit të tij të parë, ka edhe një baladë 17-minutëshe mbi vrasjen e


John Kennedyt, “Murder Most Foul” dhe një homazh për këngëtarin amerikan të bluzit Jimmy Reedin. “Rough and Rowdy Ways” është albumi i parë i fituesit të çmimit “Nobel” në letërsi që nga albumi “Stuhia” në vitin 2012, edhe pse artisti ka nxjerrë disa albume cover.

## Clooney dhe Amal, zëra për divorc pas izolimit



Çiftet në botë janë vënë në prova të vështira gjatë izolimit. Një pjesë ka forcuar dashurinë, e ndërsa të tjerë i kanë dhënë fund lidhjes së tyre. Kur bëhet fjalë për martesën e George Clooney dhe Amal Alamuddin

duket se është në krizë, e kjo për shkak të karantinës e bashkëjetesës së detyruar. Ka zëra në qarkullim që pohojnë se dyshja është gati për divorc. Por, kjo nuk është hera e parë që dalin thashetheme të tilla dhe ata kanë rezistuar.



# Dëshmitë e të huajve për Esat Pashën dhe flamurin e tij “shqiptar”

**Nga: Marenglen KASMI**

Esat Pashë Toptani vazhdon ende të mbetet një personazh historik me shumë dritëhije. Ndoshta shkaku duhet kërkuar te mania pambarim e shqiptarëve për të revizionuar çdo gjë nga e kaluara si dhe në liberalizimin e tregut të botimeve që, gërshetuar me mungesën e redaktimit shkencor, çon hera-herës në botime jo krejtësisht të sakta në pikëpamje historiografike. Sigurisht që, është normale, madje e domosdoshme, që historia të ritrajtohet në vazhdimësi. Kjo lidhet më së shumti me kërkimet nëpër arkiva vendase e të huaja dhe, për një vend të mbyllur ku ka operuar historiografia shqiptare, është e natyrshme të zbulohen në vazhdimësi dokumente të reja.

Në këtë kuadër, po zbardhim më poshtë disa dokumente dhe botime gjermane, të cilat hedhin sadopak, një dritë më shumë mbi këtë çështje.

Gjatë kërkimit në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë para disa kohësh, në fondin R 130365 ndesha në një zarf letre, i cili kishte brenda tij një shkresë përcjellëse të ambasadës austro-hungareze në Berlin të datës 7 maj 1915, që i drejtohej Ministrisë së Punëve të Jashtme gjermane me tekst: “Ambasada perandorake dhe mbretërore ka nderin t’i dorëzojë Ministrisë së Punëve të Jashtme një notë të Esat Pashës të destinuar për përfaqësuesin perandorak gjerman që ka të bëjë me flamurin kombëtar shqiptar, që i është dorëzuar të ngarkuarit me punë të perandorisë austro-hungareze në Durrës”.

Më tej në zarf gjendej nota e nënshkruar nga Esati, drejtuar përfaqësuesit gjerman në Durrës, i

cili ndërkohë ishte larguar nga Shqipëria.

Ndoshta kjo letër është një nga rastet e rralla – në mos hera e parë në dijeninë time – ku botohet një shkresë e nënshkruar nga Esat Toptani. Përmbajtja e

komandat suprem dhe gjeneral. Dhe, në fund, modeli i flamurit: një copë e kuqe me përmasa rreth 20 me 30 centimetra, me një yll të bardhë në cepin e poshtëm, djathtas. Bie në sy ngjashmëria me flamurin turk, ku është hequr

Vidit. Pas Luftës së Parë Botërore mbaroi studimet në Austri në degën e mjekësisë, por nuk e ushtroi kurrë profesionin e mjekut. Në pranverë të vitit 1923 ai themeloi në Vjenë një shtëpi botuese dhe në vitin 1929 krijoi një Shoqatë Austriako-Shqiptare (Österreichisch-Albanische Gesellschaft). Ka shkruar disa libra për Shqipërinë dhe Ballkanin.

Biografia e Esat Pashës që po japim më poshtë është shkëputur nga libri i tij “Shteti i ri – Shqipëria”, botimi II, Stuttgart 1931. Ky libër është rrëfim i një udhëtimit automobilistik që autori ka kryer në Shqipëri në vitet 1930-1931.

“[...] Princit Wilhelm nuk do t’i kishin dalë thinjat as nga një ‘second Schleswig-Holstein’ (siç quhej në Paris me ironi pozita e Shqipërisë e ndarë ndërmjet Austrisë dhe Italisë, njësoj si Schleswig-Holstein ndërmjet Austrisë dhe Prusisë – M.K) dhe as nga kryengritja epirote, nëse

në këtë kohë në Shqipëri nuk do të kishte ekzistuar një burrë i çuditshëm, i cili dinte të gatonte çorbën e tij mbi çdo zjarr të rrezikshëm. Ky ishte Esat Pashë Toptani. Jam ende i gëzuar që kam pasur rastin ta njoh personalisht këtë njeri. Jo vetëm sepse më ka mbetur në kujtesë si një personalitet tërheqës (ai dinte të paraqitej edhe si një zotëri simpatik e i ndershëm), por sepse ai ka qenë pa dyshim një nga figurat më interesante e të veçanta të historisë së re.

Gjysma e Esat Pashës ishte ajo e një uzurpatori të madh, me gjithë paturpësinë gjeniale të një komandanti mercenarësh të kohës së Rilindjes. Ndërsa, në gjysmën tjetër të tij, ai ishte një njeri i zgjuar me nuhatjen e një tregtari oriental. Me siguri do t’ia vlejë shumë ndonjëherë, të shkruhet romani i jetës së këtij njeriu.

Le të japim shkurt, shumë shkurt, historinë e jetës së tij: Esati rrjedh nga familja më e fuqishme aris-




Propozimi i Esat Pashës për modelin e flamurit të Shqipërisë në vitin 1915

shkresës është krejt formale. Ajo daton më 21 prill 1915 dhe është shkruar në Durrës. Esat Pasha i dërgon përfaqësuesit gjerman modelin e flamurit kombëtar shqiptar, gjithmonë sipas variantit të tij. Në fund të saj bie në sy një firmë e pastërvitur dhe e brishtë, çka ndoshta ilustron atë që Ekrem bej Vlora dhe bashkëkohës të tij e thonë, që Esati nuk dinte shkrim e këndim, por mesa duket kishte mësuar të firmoste me germa latine. Po ashtu, në shkresë duket qartë që teksti i saj është shkruar nga një dorë e mësuar. Gjithashtu në të vihet re edhe mania e Esatit për t’i dhënë sa më shumë pushtet vetes, kur nënshkruan si president i përkohshëm i Shqipërisë,

vetëm gjysmëhëna. Ky fakt mund të ilustron lidhjen shpirtërore të Esatit me perandorinë osmane, por po ashtu mund të vlerësohet edhe si një element qetësues për kundërshtarët e tij “dumbabistë”.

## Një biografi e pabotuar për Esatin nga Friedrich Wallisch

Shkrimtari austriak Friedrich Wallisch [Fridrih Valish 1890-1969] lindi në Moravi. Ai shërbeu në flotën ushtarake të Austro-Hungarisë dhe në vitin 1914 ndodhej në Shqipëri ku drejtonte sektorin akademik të flotës. Gjatë kësaj kohe ai raportoi për sundimin e shkurtër të Princ



tokrate në Shqipërinë e Mesme, Toptanët. U bë oficer i xhandarmërisë turke. Më pas deputet. Hyri në oborrin e Abdyl Hamitit. Bëhet i përkëdheluri i këtij sulltani. Por, intrigon kundër tij. Merret vendimi për të rrëzuar Abdyl Hamitin. Asnjë nuk merr guximim t'i japë atij këtë lajm të padëshiruar. Esati guxon. Ish i përkëdheluri i sulltanit të rrëzuar, fiton nga ky akt një respekt të veçantë të xhonturqit. Dërgohet në Shqipëri si njeriu i tyre i besuar.

Si oficer xhandarmërie i xhonturqve, ai godet me ashpërsi lëvizjet çlirimtare të shqiptarëve të veriut. Që prej kësaj kohe konsiderohet si armiku më i rrezikshëm i lëvizjes çlirimtare shqiptare. Në fillimet e luftës ballkanike ai mbledh një ushtri private dhe i vjen në ndihmë guvernatorit turk të Shkodrës, Hasan Riza Pashës, i cili luftonte kundër ushtrisë malazeze. Gjatë rrethimit, Hasan Rizai vritet në mënyrë të pabesë. Nga kush? Vrasja e tij e çon Esatin në majë të piramidës. Ai bëhet pasardhësi i Hasanit si mbrojtës i qytetit. Bota e shikon Esatin si mbrojtësin e Shkodrës. Papritur, ai u dorëzon armiqve qytetin pa ndonjë arsye të dukshme.

Pasuria e tij rritet. Të afërmit e tij vdesin njëri pas tjetrit në vitet e tyre më të mira. Esati përfiton pasurinë e tyre. Ushtria e tij private – të cilën ai ka arritur në sajë të marrëveshjeve ta nxjerrë nga Shkodra – është aktive, si në luftë edhe në paqe. Ai e përdor atë për të përzënë fshatarët e Shqipërisë së Mesme nga tokat e tyre. Pasuria e tij rritet edhe më shumë. Fuqitë e Mëdha e njohin Shqipërinë si shtet të pavarur. Esati (më parë një shtypës i përgjakshëm i lëvizjeve çlirimtare) papritur shfaqet zjarr e shpuzë për pavarësinë e Shqipërisë. Por, nën mbretin Esati I. Për fat të keq kjo gjë nuk funksionon. Asnjë nuk e dëshiron mbretin Esat. Madje, as familja e tij nuk e dëshiron këtë gjë. Ajo trembet se, gjendja shëndetësore e anëtarëve të tjerë të familjes mund të përkeqësohet edhe më shumë. Plani “mbreti Esat I” do të ruhet për të ardhmen.

Gjithsesi gjërat nuk ecin kaq shpejt. Fuqitë e Mëdha zgjedhin me të drejtë Wiedin për princ. Kandidati i kurorës, Esati, brenda njëzet e katër orësh shndërrohet në shërbëtorin më besnik të sundimtarit të tij. Ai shkon në Neuwied, si edhe në Vjenë e Romë në krye të delegacionit shqiptar. Dekorohet në Austri dhe Itali me medaljen e Kryqit të Madh. I jep besën princit Wilhelm se do ta mbështesë atë me gjithë ndikimin dhe fuqinë e tij deri në frymën e fundit. Premtium i çuditshëm i një vasali. Në këto fjalë bese vërehen ngjyra kërcënimi, apo jo? Bëhet krahu i djathtë i princit. Lejon t'i delegohet një tjetër personi posti i kryeministrit dhe vetë kënaqet me postin e Ministrit të Luftës, Ministrit të Brendshëm dhe Gjeneralimit. Kësisoj ai ka në

dorë gjithë fuqinë civile dhe ushtarake.

Ushtria e tij private vazhdoi të ishte aktive. Nëse dëshiron të tregohesh i sjellshëm, këto banda mund t'i quash gardistë të Esatit. Madje, persona tejet të sjellshëm i quajnë ata xhandarët e Ministrin të Luftës. Sa herë xhandarët e vërtetë, ata të qeverisë së princit, kërkojnë të shkojnë në vendrojat e tyre në brendësi të vendit, përfshihen çdo herë në luftime me njerëzit e Esatit. Betejat zgjasin aq kohë sa trupat e qeverisë marrin nga Durrësi urdhrin që të shmangin luftimet me xhandarët e Ministrin të Luftës! Kësi gjërash ndodhin në këto kohë paqësore në një vend evropian të shekullit XX.

Që një figurë si Esati nuk mund të kishte ekzistuar në Shqipëri para 20 vjetësh, vërteton atë që unë dua të vërtetoj: Aty (në Shqipëri – M.K) mesjeta sapo ka perënduar tanimë, në shekullin e njëzetë. Ky vend ka kapërcyer brenda natës në kohën moderne.

Vazhdojmë më tej me Esat Pashën: Fuqitë e Mëdha nuk dëshironin Esatin I, por Wilhelm I. Në rregull, atyre duhet t'u tregohet se nuk kishin të drejtë. Esati bën një rezistencë pasive kundër epirotëve pro grekë. Meqenëse kundër kryengritësve nuk mund të mbarohet punë në rrugë luftarake, nënkoloneli holandez Thomson, si përfaqësues i shqiptarëve, kërkon të mbyllë luftën pa gjak duke bërë lëshime të vogla. Ai negocion me Zogarin, drejtuesin e epirotëve. Esati urdhëron menjëherë kthimin e holandezit nga Epiri. Njerëzit e Esatit i ofrojnë marrëveshje joshëse qeverive në Romë, Athinë dhe Beograd.

Por, e gjitha kjo histori po zgjaste shumë për Esatin. Një ditë të bukur ushtrinë e tij private marshoi në drejtim të Durrësit, me qëllim që të bënte të padëmshëm Princin, athua se ky nuk kishte boll probleme. Kjo do të thotë, Esati e organizoi me zgjuars këtë gjë. Vetë qëndroi në Durrës – athua se nuk kishte asnjë djeni se çfarë po ndodhte dhe prej aty urdhëroi ushtrinë e tij private të sulmonte qytetin. Ministër i Brendshëm dhe Ministër Luftime çuditshëm, i cili nuk di asgjë. Holandezët nën drejtimin e majorit Sluys ndihmuan në thyerjen e sulmit. Nuk përbënte më sekret që ekselencia e tij, Ministri i Luftës ishte organizatori i sulmit. Kësisoj ai duhej të largohej për në Itali, ku rrugët për të ishin të hapura. Në mesin e muajit qershor u zhvilluan betejat të reja në rrethinat e Durrësit. Koloneli Thomson, një njeri i çmuar dhe i zoti ra në luftime. Gjendja e Wilhelmit bëhej gjithnjë e më e vështirë. Vullnetarë austriakë u ofruan në shërbim të tij. Në Vjenë u rekrutua një legjion shqiptar.

Por, pastaj në Vjenë kishin të tjera probleme. Erdhi lufta. Wilhelmi humbi gjysmën e austriakëve, gjermanëve dhe holandezëve. Pasi ai kishte hipur njëherë në bordin e një anijeje, me qëllim që



Vila e Esat Pashës në Durrës

të mos të shndërrohej si të thuash në një pasardhës të Maksimilianit të Meksikës, atij i duhej të largohej më 5 shtator 1914 përfundimisht nga Shqipëria.

Duket se Esatit iu hap rruga që me ndihmë të Antantës të realizonte dëshirën e tij të hershme. Ai tanimë ishte regjent në Durrës. Por, helli, që ai e kishte përdredhur kaq shumë, tashmë po rrotullohej kundër tij. Armiqtë e tij shqiptarë marshuan drejt qytetit. Ndër vite ai kishte bërë plot armiq. Më pas erdhën austriakët dhe gjermanët, të cilët kishin me të ende një llogari të hapur. Esati duhej të largohej përsëri. Ai ishte kujdesur prej kohësh të hapte llogari me shuma të majme në banka të mëdha europiane. Ai u shpërngul në Paris dhe vazhdoi të thurte intrigat e tij si gjatë kohës së luftës edhe pas saj. Ai ishte duke përgatitur terrenin për t'u “vëllazëruar” me Jugosllavinë, derisa në një ditë qershorit të vitit 1920, iu mor jeta plot stil. U qëllua për vdekje në Paris nga një patriot shqiptar. Do të kishte qenë tepër absurde nëse Esat Pasha do të kishte pasur një vdekje natyrale [...].

### Mysafir në shtëpinë e Esat Pashës

Në zbatim të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit duhej të përgatiste kushtet e ardhjes së princ Wiedit në Shqipëri. Ndërkohë që Ismail Qemali u shpreh i gatshëm të japë dorëheqjen si kryetar i qeverisë së Vlorës, Esat Pashë Toptani ende nuk ishte bindur të hiqte dorë nga sundimi i tij në Shqipërinë e Mesme dhe t'i hapte kësisoj



Shtëpia e Esat Pashës në Tiranë

rrugën ardhjes së princ Wied-it në Shqipëri. Në këtë kuadër, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit vendosi të dërgonte tek Esati në Durrës dy përfaqësues, për të biseduar e për ta bindur atë të jepte dorëheqjen. Këta ishin konsulli i përgjithshëm britanik Lamb dhe përfaqësuesi gjerman në KNK, Sekretari i Dytë në shërbimin diplomatik Rudolf Nadolny. Në kujtimet e botuara të Rudolf Nadolnyt në Köln në vitin 1985, ai e përshkruan takimin me Esatin si më poshtë:

“[...] Komisioni i Kontrollit vendosi të largonte nga posti si Ismail Qemal Beun ashtu edhe Esat Pashën dhe të ftonte për të ardhur në Shqipëri Wilhelm Wiedin, i cili ndërkohë ishte shprehur dakord të hiqte në fronin shqiptar. Ismail Qemal Beu ishte i gatshëm të jepte dorëheqjen. Ai u shpreh menjëherë i gatshëm me kusht që, edhe Esat Pasha të jepte dorëheqjen. Kjo ishte më e vështirë, sepse Esati sundonte si “Shef i Ekzekutivit të Senatit për Shqipërinë e Mesme” dhe as që i shkonte ndërmend një gjë e tillë. Kësisoj, u mor vendimi që, konsulli i përgjithshëm britanik Lamb dhe unë të hipnim në bordin e kryqëzorit austriak “Pantera” dhe të udhëtonim për në Durrës për të negociuar me të.

U nisëm të dy në një mbrëmje me kryqëzarin dhe, herët në mëngjes hodhëm spirancën në gjirin e Durrësit, përballë kodrës ku ishte shtëpia e Esat Pashës. Rreth orës 09.00, të shoqëruar nga dy marinare morëm të përpjetën për në shtëpinë e sundimtarit.

Bisedimet rezultuan shumë të vështira. Esati nuk binte dakord të jepte dorëheqjen. Ai pinte duhan dhe ndërkohë kishte mbaruar dy paketa. Ra qetësia, sepse asnjë

nuk dinte më çfarë të thoshte. Esati hodhi vështrimin nga dritarja dhe pyeti përse kryqëzori nuk ishte afruar më pranë bregut. I thashë se kryqëzori nuk është aspak larg, por vetëm 2500 metra prej shtëpisë. Ai më pyeti se nga e dija me kaq saktësi. Iu përgjigja se, këtë gjë ma kishte thënë oficeri i artillerisë, kur po përgatiste topat. Esati u zverdh në fytyrë dhe bisedimet filluan nga e para. Brenda një kohe relativisht të shkurtër ramë dakord. Esati do të ishte në krye të delegacionit që do të shkonte për të marrë princin në Gjermani. Nënshkruam marrëveshjen me shkrim dhe i telegrafuam Komisionit të Kontrollit që mund të vinin. Lamb-i u kthye në Vlorë. Ndërsa unë pranova ftesën e Esat Pashës për ta shoqëruar atë në vendlindjen e tij, Tiranë.

Mëngjesin tjetër u nisëm. Ishin 36 km dhe vërehej qartë se sa i begatë dhe i lënë pas dore ishte ky vend. Rreth drekës mbërritën në Tiranë. Ishte një qytet i vjetër me pemë të lashta bliri dhe me vilën me veshje druri të Esat Pashës, të pikturuar plot shije artistike.

Dreka ishte shumë festive, por mua nuk më shijoi. Ajo përbehej nga 15 gatime të ndryshme – të gjitha me mish qengji. Kulmi u arrit me kokat e pjekura të qengjit. Kisha zënë vend në të djathtë të Esatit dhe ai më vuri personalisht një kokë qengji në pjatë. Qengji më vështroi me sytë e fikur dhe mua mu rrotullua stomaku. Thashë se nuk mund ta haja këtë gjë, sepse nuk isha i mësuar me zakonet e vendit. Prandaj, Esati duhej ta hante për mua kokën e qengjit. Esatit i erdhi shumë keq, por e mori kokën e qengjit dhe e hëngri me të vërtetë, pasi kullufiti fillimisht kokën që kishte në pjatën e tij. Fillimisht hëngri sytë. Ishte e tmerrshme të shikoje këtë gjë. Unë hëngra vetëm bukë dhe fruta, pasi kisha shtyrë me zor një pjatë me supë, të cilën për pak sa nuk e nxora. Shqiptarët nuk ngopeshin së ngrëni dhe as u shkonte ndër mend të pushonin. Pas drekës bëmë një shëtitje të shkurtër në qytet dhe pastaj erdhi darka, që ishte e ngjashme me vaktin e drekës. Mu shpif edhe më shumë. Natën e kalova po aty. Lavamani i dhomës time ishte një konstrukt primitiv prej druri, por me legenë elegantë argjendi dhe me një gjym uji po kaq të përkryer. Shtrati ishte krejt i thjeshtë dhe prej druri, por jastëku dhe çarçafët ishin qëndisur me fije ari dhe mëngjesin tjetër e kisha të pikturuar në trup gjithë modelin. Mëngjesin tjetër u nisa për në Durrës në një gjendje të mjerueshme. Me të mbërritur rashë në shtrat i sëmure për vdekje. Në mbrëmje u zvarrita në restorant dhe porosita spinaq me vezë, por për hir të zotit, vezën duhej ta skuqin me gjalpë dhe jo me dhjamë qengji. Më servirën vërtet spinaq me vezë. Veza ishte skuqur me gjalpë, ndërsa spinaqi ishte përgatitur me dhjamë qengji – çka mua sigurisht që më sëmuri prapë [...]”./Telegrafi



# Muzikantët e famshëm që kishin probleme me dëgjimin

Muzika mund të jetë vajtuese, e qetë, agresive, por mbi të gjitha ajo duhet dëgjuar me zë të lartë. Mendoni për koncertin më të mirë që ju keni marrë pjesë ndonjëherë. Muzika është melodioze dhe të bën për vete, por kur ktheni në shtëpi, ju vëreni zukatje në veshë nga tingujt e fortë të melodisë.

Tani, imagjinoni muzikantët, që veshët e tyre kanë më shumë ekspozim, shumë më të shpeshtë me tingujt. Rasti më i veçantë i kësaj liste është ai Ludwig van Beethoven. Viti 1802 është një vit shumë i vështirë për të pasi e dashura e tij Xhuljeta Guiciardi të cilës i kishte kushtua "Sonata nën Dritën e Hënës" e lë dhe bashkë me të edhe dëgjimi i tij, i cili kishte filluar t'i shfaqë probleme që prej vitit 1796.

Trishtimi i tij ishte aq i madh sa që kompozon "Testamenti i Hailingestatit" dhe ua dërgon dy vëllezërve të tij me lutjen që të lexohet dhe të kryhet pas vdekjes së tij. Fillon duke thënë: "O njerëz që më konsideroni dhe më gjykoni te ligë dhe gjysmënjeriu sa shumë padrejtësi më bëni. Zemra ime që kur isha fëmijë ishte e dhënë pas Mirësisë. Ndiheha gati të realizoja gjëra të mëdha. Por mendoni se këtu dhe gjashtë vite më ka goditur një fatkeqësi e pakorrigjueshme... Kisha vendosur të jepja një fund. Vetëm arti më përmbajti. Më dukej e pamundur të braktisja botën pa përfunduar çfarë isha destinuar të japë". Megjithatë, këta muzikantë kanë arritur të krijojnë muzikë që do ta kujtoni për tërë jetën.

## Neil Young

Neil Young (lindur më 12 nëntor, 1945), është një kantautor kanadez, i cili është konsideruar si një nga muzikantët më me influencë të gjeneratës së tij. Ai ka lënë gjurmë të pashlyeshme në botën e muzikës dhe zë një vend të veçantë në muzeun e "The Rock and Roll Hall of Fame and Museum", që ndodhet në Ohio, USA. Në këtë muze shpaloset historia e disa artistëve, producentëve më me influencë që kanë kontribuar në industrinë e muzikës dhe veçanërisht të zhanrit të muzikës Rock and Roll. Young ka qenë nderuar nga muzeu "Hall of Fame" si solo artist në vitin 1995 dhe si anëtar i bandës "Buffalo Springfield", grup amerikan i muzikës rok. Këngët më të bukura janë baladat "Heart of Gold" dhe kryevepra e "hard rock" është "Cowgirl in the Sand", e cila ka pasur një kritikë të suksesshme dhe popullaritet të pabesueshëm. Nëpërmjet të gjithave, ai ka vuajtur nga "tinnitus" – "zukatje në veshë", shqetësim i përbashkët për muzikantët e muzikës rok and roll, e cila konsiston në një tringël-

limë të vazhdueshëm në vesh. Young ka krijuar mbi 30 albume unike.

## Ozzy Osbourne

John Michael "Ozzy" Osbourne (lindur më 3 dhjetor, 1948) është një kantautor anglez, karriera e të cilit shtrihet më shumë se 40 vjet. Osbourne konsiderohet si një nga pionierët e parë të bandës "Black Sabbath" të muzikës "heavy metal" dhe mbetet një nga muzikantët më të suksesshëm i të gjitha kohërave. Gjithashtu, ai është edhe organizuesi i "Ozzfest", festival që zhvillohet çdo vit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila mirëpret grupe të ndryshme të muzikës "heavy metal". Pavarësisht nga sukseset e tij, Osbourne vuan nga humbja e dëgjimit.


Në dhjetor të vitit 2010, Osbourne shiti më shumë se 100 milionë disqe në të gjithë botën. Po në vitin 2010, fitoi "Literary Achievement", çmim i dhënë nga Sony Pictures Studio, Kaliforni.

## Phil Collins

Philip David "Phil" Collins (lindur më 30 janar të vitit 1951) është një kantautor, pianist, aktor. Këngëtari britanik u bë i famshëm si si vokalist dhe baterist me grupin e rrokut "Genesis". Këngët e tij kanë qenë në vendet e para të hitparedeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Britaninë e Madhe në periudhën midis 1978 dhe 1994. Mbas dyzet vitesh suksesi, muzikanti legjendar ka bërë të ditur se ai po vuan nga një sërë problemesh me shëndetin vitet e fundit. Dëgjimi i tij është dëmtuar nga të luajturit live dhe ka pasur shqetësime me shtyllën kurrizore, gjë e cila bën të pamundur uljen e tij sërish në bateri.

## George Martin

George Martin (3 janar, 1926) është një producent, kompozitor dhe muzikant anglez. Shpesh herë ai është referuar si "the Fifth Beatle" – "Bitëllësi i Pestë", titull që i është vënë falë punës së tij si producent i albumeve origjinale të grupit të famshëm "The Beatles". Gjithashtu, ai është konsideruar si një nga producentët më të mëdhenj i të gjitha kohërave, ku 30 herë radhazi ka qenë në krye të hitparedit anglez dhe 23 herë në



hitparedin amerikan. Martin ka kompozuar edhe kolonat zanore të filmave "Yellow Submarine" 1968, dhe "Live and Let Die" 1973. Ai ka marrë shumë çmime nderi ndër to më i fundit është "Doctor of Music" nderuar nga Universiteti i Oxford-it më 29 qershor të këtij viti. Si Collin ai është i detyruar të tërhiqet nga muzika për shkak se dëgjimi i tij është i dëmtuar.

## Will.i.am

William James Admas, Jr (15 mars, 1975), njohur më shumë si will.i.am është këngë autor, aktor, producent dhe raper amerikan. Ai u bë më shumë i njohur si themeluesi i grupit të muzikës pop dhe hip hop "The Black Eyed Peas" së bashku me këngëtaren e muzikës pop apl.de.ap dhe "Taboo", më vonë njohur si këngëtarja Fergie. will.i.am ka realizuar disa albume të suksesshme si "Monkey Business and Elephunk" 2003. Si producent muzike ai ka bashkëpunuar me artistë të njohur të muzikës si Britney Spears, U2, Rihanna, Justin Timberlake, Juanes dhe shumë të tjerë.

Çmimi i fundit ka qenë në 2010 si "Best Pop Performance by a duo or Group" me këngën "I Gotta Feeling". Sipas will.i.am, çdo heshtje është e ndërprerë nga një tingëllim i dhimbshëm, e cila e frymëzon atë për të krijuar muzikë në të gjitha orët e ditës.

## Brian Wilson

Brian Douglas Wilson (lindur më 20 qershor, 1942) është një muzikant amerikan, i famshëm si kantautor i grupit "The Beach Boys".

Wilson si shumë të tjerë muzikantë ka pasur probleme me dëgjimin. Bob Dylan një tjetër muzikant i famshëm ka thënë për shqetësimin e Wilson-it: "Jezus, shiko atë vesh."

Ai duhet t'ia dhurojë atë Smithsonian. Smithsonian USA, është kompleksi më i gjerë kërkimor në botë ku përfshihen 19

muze, 9 qendra kërkimore dhe është binjakëzuar me më shumë se 140 muze në botë. Edhe pse me shumë probleme shëndetësore, ai orkestron një nga albumet më të shkëlqyer i të gjitha kohërave "Pet Sounds", 1966. Përveç çmimeve të tjera marra gjatë karrierës së tij, më 20 maj 2011, Wilson u nderua me çmimin "George and Ira Gershwin Award" nga Universiteti i Kalifornisë në Los Angelo-s.

## Jeff Beck

Geoffrey Arnold "Jeff" Beck (lindur më 24 qershor, 1944) është një kitarist anglez. Karriera e tij filloi duke lozur me "The Yardbirds", grup muzikor roku formuar në vitet '60. Në të njëjtin grup kanë qenë edhe kitaristi i shquar Eric Clapton dhe Jimmy Page. Gjithashtu, Beck formoi edhe dy grupe të tjera muzikore "The Jeff Beck Group" dhe "Beck, Bogert&Appice". Ai është renditur i 14 në listën e "Rolling Stone" (revistë muzikore amerikane) si një nga kitaristët më me influencë të muzikës rok. Kanali amerikan MSNBC e ka cilësuar si "kitaristi i kitaristëve".

Shumica e këngëve të tij janë instrumentale. Stili muzikor i këngëve të tij janë jazz fusion, blues-rok dhe heavy metal. Në 4 Prill, 2009 ai u fut në "Rock and Roll Hall of Fame of Museum" si anëtar i grupit "The Yardbirds" në vitin 1992 dhe si solo artist në vitin 2009.

## Eric Clapton

Eric Patrick Clapton (lindur më 30 mars, 1945) është një kitarist, këngëtar dhe kompozitor anglez. Kitaristi legjendar ka qenë pjesëtar i grupeve rok "Cream" dhe "The Yardbirds", në këtë grup ka qenë edhe Jeff Beck. Karriera e tij njihet më shumë si solist. Stili i muzikës që ai loz është blues dhe rok. Vitin që shkoi, nxori një album "antik", ku përzgjedh rreth 20 këngë të shkruara mes viteve '30 dhe '50. Clapton thekson se ky album është si një lloj autobiografie. Në

këto këngë të zgjedhura ka bluz dhe xhaz. Këngët e tij të famshëm janë "Layla", "Wonderful Tonight", "My Father's Eyes", "Rock N' Roll Heart", "Crossroads", "White Room" etj.

## Pete Townshend

Peter Denis Blandford "Pete" Townshend (lindur më 19 maj, 1945), është një kitarist roku, vokalist, kantautor dhe është i njohur si kitaristi i grupit rok "The Who". Karriera e tij në këtë grup vazhdoi për më shumë se 40 vjet, dhe ky grup është konsideruar si një nga grupet më me influencë në vitet '60 dhe '70 dhe sipas Eddi Vedder (muzikant amerikan), ndoshta grupi më i suksesshëm që këndon live. Këngët më të suksesshëm janë "My Generation", "Won't Get Fooled Again" dhe "Pinball Wizard".

Muzika me volum të lartë, pajisjet piroteknike kanë shkaktuar efekte të mëdha negative për humbjen e dëgjimit të muzikantit të famshëm. Pavarësisht nga kjo vështirësi, ai, si çdo anëtar tjetër i kësaj liste, vazhdon të luajë nëpër koncerte ekstravagante live.

## Ludwig van Beethoven

Ludwig van Beethoven, lindi më 16 dhjetor, 1770 në Bon, Gjermani dhe vdiq më 26 mars të vitit 1827 në Vjenë, Austri. Beethoven ka qenë një kompozitor dhe pianist midis periudhave të Klasicizmit dhe Romantizmit në artin e muzikës perëndimore. Ai do të mbetet një nga kompozitorët më të shquar i të gjithë kompozitorëve i të gjitha kohërave. Aty nga viti 1800 filloi të humbiste dëgjimin. Ai vuajti nga dëmtime të brendshme që i ja vështirësuan atij dëgjimin e muzikës. Mendohet se njëri nga shkaktarët ishte uji i ftohtë, në të cilin ai e vendoste kokën për të mos e zërë gjumi gjatë punës. Edhe humbja e dëgjimit të tij mbetet mister, muzika e tij do të jetojë përgjithmonë, dëgjuar dhe pëlqyer nga gjeneratat e reja. / KultPlus.com

# A ka ndodhur vërtet Lufta e Trojës?

Bazat e letërsisë perëndimore, gjurmohen zakonisht në epikat e Greqisë së Lashtë. Veprat homerike si "Iliada" dhe "Odisea" janë ndër veprat më të njohura të letërsisë. Ato flasin mbi historinë e Luftës së Trojës, një rrethim 10-vjeçar i një qyteti të quajtur Trojë nga grekët. Iliada tregon se si grua e bukur e mbretit të Spartës Menelau, Helena, u rrëmbye nga princi trojan, Paridi.

Për të rimarrë Helenën dhe për të ndëshkuar trojanët për gjestin poshtëruar të Paridit, Menelau ndërmoi një sulm të madh ushtarak kundër Trojës. Për 10 vjet më radhë grekët e mbajtën të rrethuar qytetin e Trojës, derisa më në fund falë një dredhie ajo u mposht dhe u shkatërrua.

Tre mijë vjet më vonë, arkeologu gjerman Hajnrih Shliman zbuloi një sit arkeologjik të njohur si Hisarlik në Turqi, për të cilin shumë ekspertë besojnë se është qyteti i shumëpërfolur i Trojës. Qyteti u shkatërrua diku në Epokën e Bronzit të Vonë.

Gjithsesi, pyetja nëse shkatërrimi ishte apo jo vepër e një ushtrie greke, mbetet pa përgjigje. Arkeologët e kanë studiuar prej kohësh sitin në fjalë, dhe nuk bien ende dakord me mundësinë që ka ndodhur realisht një ngjarje e tillë. Burimet janë të kufizuara, dhe ekspertët janë ende shumë të ndarë nëse historia e përshkruar tek "Iliada", bën fjalë për një luftë të vërtetë.

## Epikat e Homerit si një burim historik

Burimi kryesor i informacionit që ne kemi mbi Trojën dhe Luftën e Trojës, vjen nga "Iliada" e Homerit. Por fatkeqësisht, "Iliada" është kryesisht një vepër e ardhur në ditët tona e përcjellë gojarisht për breza me radhë, para se më në fund të shkruhej.

Kjo histori e gjatë orale, hedh dyshime mbi saktësinë e rrëfimit, dhe përshkrimet e ngjarjeve që ndodhin në libër janë të dyshimta. Për më tepër, Lufta e Trojës ndodhi diku në shekullin XIII Para Krishtit, pra të paktën 5



shekuj përpara datës më të hershme të kopjes fizike të Iliadës. Pra "Iliada" na tregon më shumë rreth shoqërisë, luftës dhe kulturës në shekullin IX Para Krishtit, sesa në lidhje me Epokën e Bronzit. "Iliada" është pa asnjë dyshim një nga veprat më të rëndësishme të letërsisë botërore, dhe është krahasuar me Biblën për aftësinë e saj ndikuese tek arti, letërsia dhe morali perëndimor.

Grekët, dhe shumë komentatorë të tjerë të lashtë si Herotodi, besonin se Lufta e Trojës ishte një ngjarje historike që ndodhi realisht në "Epokën e Artë" të historisë së tyre. Shumë arkeologë modernë pajtohen me këtë konstatim, duke besuar se më së paku ka ekzistuar një lloj konflikti midis grekëve dhe trojanëve në veriperëndim të Turqisë në njëfarë kohe në Epokën e Bronzit të Vonë.

Megjithatë, është gjithashtu e vërtetë që detajet janë dramatizuar shumë, dhe se rrëmbimi i Helenës nuk ka qenë me siguri shkak i luftës. Bazuar në dokumente nga civilizime të tjera të kohës, ekspertët spekulojnë se shkak ishte ose politik ose "aksidental", gjë që do të thotë se Troja ishte thjesht një nga shumë

qytetet, të cilat ranë viktimë e sulmeve nga grekët.

## Siti i sotëm arkeologjik

"Kandidati" më i njohur si qytet i Trojës, është një sit arkeologjik në veriperëndim të Turqisë i quajtur Hisarlik, i zbuluar në vitin 1870 nga arkeologu gjerman Hajnrih Shliman. Aty ekzistojnë 9 nivele vendbanimesh, dhe secili nivel është i ndarë në nën-nivele.

Arkeologët e hershëm besonin se niveli 7 A apo 7 B ishin Troja mitike, por të dhënat mbi shkallët prej qeramikes i kanë përjashtuar ato nivele. Sot niveli 6H, është kandidati më i mundshëm, pasi duket se ai është shkatërruar në një farë kohe në fund të shekullit XIII Para Krishtit.

Arkeologët e dinë që niveli 6 H u shkatërrua dhunshme gjatë atij shekulli, por nuk dihet natyra e shkatërrimit të tij. Zona nuk ishte shumë mbresëlënëse, me një kështjellë të vogël, dhe vetëm disa themele të dëmtuara që ekzistojnë ende sot.

Si e tillë, ka shumë pak prova të një vendbanimi të madh, ndaj arkeologët spekulojnë se ky sit mund të jetë shkatërruar nga ndonjë fatkeqësi natyrore, nga një pushtim, apo nga ndonjë

ngjarje tjetër shkatërruese. Nivele të tjera të sitit, dihet që janë shkatërruar nga dhuna njerëzore, përfshirë nivelin 7 A, por shumica e studiuesve i kanë përjashtuar këto nivele si kandidatë të mundshëm për qytetin e Trojës nga Iliada.

## Teori mbi gjasat historike të një Luftë Trojane

Për shkak të mungesës së provave të dobishme në Hisarlik, arkeologët vazhdojnë të mos bien dakord nëse Lufta e Trojës ka ndodhur vërtetë apo jo. Karl Blegen, një arkeolog që germoi në Hisarlik në vitet 1930, ka thënë se "nuk mund të dyshohet më" që grekët vendosën rrethimin në vendin e njohur si Hisarlik, dhe në fund e shkatërruan atë. Gjithsesi, ky mendim ishte i bazuar në besimin se niveli 7 A ishte Troja mitike, ndërsa ekspertët modernë nuk pajtohen me këtë pretendim.

## Hisarlik: A është Troja?

Në fakt, shumë historianë e kanë kritikuar Blegen, për vendimin e tij të nxituar për ta shpallur nivelin 7 A si Trojën e vërtetë. Moez Finli

dhe të tjerët, e kanë quajtur përfundimin e tij një "akt besimi", dhe treguan një mungesë thuajse totale të provave, që sugjerorin se rënia e Trojës u shkaktua nga një ushtri greke.

Historianë si Finli janë shumë më konservatorë në interpretimin e provave të gjetura në Hisarlik, dhe mbështeten tek tekstet bashkëkohore të asaj periudhe, konkretisht në ato të Hititëve, që në shkrimet e tyre përmendin një sit që mund të jetë Troja.

Ata sugjerojnë se shkatërrimi i këtij qyteti, mund të ketë qenë ose politik ose "aksidental", çka do të thotë se niveli 6 H u pushtua si pjesë e një plaçkitjeje ose bastisjeje në shkallë të gjerë. Teoria më e zakonshme, është se tregimet e Iliadës janë kryesisht të pavërteta, por kanë lindur nga një ose më shumë të vërteta të vogla nga e kaluara e largët e grekëve.

Ndoshta ka pasur një konflikt të Epokës së Bronzit, historia e të cilit mbijetoi shekuj, u transmetua gojarisht, dhe siguroi bazën mbi atë që u bë më pas guri i themelit të letërsisë dhe mendimit perëndimor. Shumica bien dakord se shkak i një lufte të tillë, ka qenë më shumë gjasa politike sesa romantike, dhe se në të ishin përfshirë më pak luftëtarë.

Deri në ditën kur do të zbulohen më shumë të dhëna, nuk ka asnjë mënyrë për të arritur në përfundimin se Lufta e Trojës, ishte një ngjarje e vërtetë. Për shkak të mungesës së provave, edhe për të dëshmuar se Hisarliku është Troja e vërtetë, çështja nëse Lufta e Trojës u zhvillua vërtetë ka mbetur pa përgjigje.

Sidoqoftë, duke pasur parasysh që "Iliada" është një vepër letrare e transmetuar gojarisht për shekuj me radhë, para se të shkruhej, arkeologët kanë hezitur të konstatojnë se një ngjarje e tillë ka ndodhur vërtetë. Por shumica e tyre janë dakord se me shumë gjasë, "Iliada" dhe "Odisea" të jenë frymëzuar më së paku nga një ekspeditë ushtarake në shkallë të gjerë, që ka ndodhur dikur në Epokën e Bronzit të Vonë. / *DailyHistory - Bota.al*



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Ballkani rikthehet në vendin e tretë, Feronikeli mposht Llapin

Ballkani dhe Feronikeli të dielën u janë gëzuar fitoreve, kurse të shtunën nga tri pikë i kanë rrëmbyer edhe Prishtina, Gjilani dhe Flamurtari. Gara për titull vazhdon të bëhet gjithnjë e më interesante



**IPKO Superliga**

Ballkani - Trepça '89	3-1
Feronikeli - Llapi	2-1
Drenica - Flamurtari	1-2
Gjilani - Vushtrria	3-0
Prishtina - Dukagjini	4-1
Drita - Ferizaj	2-0

**TABELA**

		PIKË
1. Drita	25	52
2. Prishtina	25	50
3. Ballkani	25	49
4. Gjilani	25	48
5. Feronikeli	25	43
6. Llapi	25	37
7. Drenica	25	34
8. Flamurtari	25	32
9. Trepça '89	25	27
10. Ferizaj	25	25
11. Vushtrria	25	16
12. Dukagjini	25	10

Në xhiron e radhës takohen:  
Feronikeli-Drenica, Llapi-Prishtina, Dukagjini-Gjilani, Vushtrria-Drita, Ferizaj-Ballkani, Trepça '89-Flamurtari.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 21 QERSHOR** - Skuadra e Ballkanit nga Suhareka, pas suksesit në garën e Kupës, në të cilën u kualifikua në finale, ka arritur edhe një sukses tjetër, pasi të dielën e ka mposhtur Trepçën (3-1). Ndeshja për djelmoshat e Ismet Munishit nuk ishte aspak e lehtë pasi fitoren e kanë siguruar në dymbëdhjetë minutat e fundit, kurse angazhimi i skuadrës mysafire ishte në nivel të jashtëzakonshëm. Në minutën e 19 Jetmir Topalli e hapi serinë e golave për 1-0. Katër minuta më vonë mysafirët e barazuan rezultatit me golin e shënuar nga penalltia nëpërmjet Arb Manajt. Pjesa e parë u mbyll me rezultat 1-1, ani pse rastet ishin të shumta. Në pjesën e dytë Ballkani sulmoi

më shumë dhe arriti të kalojë në epërsi në minutën e 78, kur Ermal Krasniqi realizoi për 2-1. Tre minuta para fundit të ndeshjes për vendësit shënoi edhe Mirlind Daku. Pas tri pikëve, Ballkani është rikthyer në pozitën e tretë me 49 pikë, kurse Trepça '89 është e nënta me 27 pikë. Fitores i është gëzuar edhe skuadra e Feronikelit që e mposhti Llapi (2-1) në ndeshjen e zhvilluar në Drenas. "Nikli" kaloi i pari në epërsi në minutën e tetë, kurse Mevlan Zeka realizoi nga penalltia për 1-0. Llapi nuk u dorëzua dhe e barazoi rezultatit me golin e shënuar nga Erlis Ymeri (19). Në minutën e 82-të Behar Maliqi u ndëshkua me karton të kuq, kurse një minutë më vonë nga penalltia Mevlan Zeka e vulosi rezultatit përfundimtar 2-1. Pas kësaj ndeshje Feronikeli zë vendin e pestë me 43 pikë, kurse

Llapi është në pozitën e gjashtë me 37 pikë. Prishtina e ka kujtuar pozitën e dytë, pas tri pikëve të marra nga përballja me Dukagjinin e Klinës (4-1). Rezultatit e zhbllkoi Otto John me golin e shënuar me kokë pas harkimit të Armend Thaçit në minutën e 30-të. Baraspeshën në rezultat e riktheu Altin Merlaku, po ashtu me golin e shënuar me kokë në minutën e 43-të. Sidoqoftë, rezistencës së mysafirëve i dha fund sulmuesi me përvojë i prishtinasve, Ahmet Januzi, i cili shënoi në

minutën e 68, kurse më pas dilemat e fitores i hoqën Meriton Korenica dhe Kreshnik Uka me golat e shënuara në minutat 85 e 88. Të shtunën Gjilani ka shënuar fitore të lehtë në përballje me Vushtrrinë (3-0), duke e mbajtur hapin me skuadrat e tjera të kreut në garën për titull të kampionit. Golat për gjilanasit i shënuan Muamer Svraka, Franc Veliu dhe Keita Razak. Ndërkohë, fitore tejet të rëndësishme në garën për mbijetesë ka realizuar

Flamurtari si mysafir i Drenicës (1-2). Autorë të golave për kuqezinjtë e kryeqytetit ishin Shend Kelmendi dhe Adem Maliqi, kurse golin e vetëm për drenicasit e realizoi Alban Shillova nga penalltia në minutat shtesë të ndeshjes.

## Krasniqi, teakwandsiti që po arrin sukses të mëdha në Zvicër

**PRISHTINË, 21 QERSHOR** - Teakwandsiti nga Rahoveci, Bashkim Krasniqi, është duke kaluar një karrierë tejet të suksesshme në këtë sport në shtetin e Zvicrës. Krasniqi në një intervistë për "KosovaPress" ka shpalosur edhe sukseset që i ka arritur që nga viti 1995, kur edhe ka filluar të merret me sportin e teakwandos. Përveç sukseseve në rrafshin ndërkombëtar, ai ka rezultuar i suksesshëm edhe në rrafshin kombëtar, ku në vitin 2009 është shpallur kampion në Kosovë dhe Shqipëri. "Kam filluar të merrem me teakwando në vitin 1995. Jam kampion kombëtar dhe mbarëkombëtar që nga viti 1997. Kam marrë pjesë në disa gara



kombëtare dhe mbarëkombëtare. Në Zvicër kam qenë edhe kundërshtari më i mirë në të gjitha kategoritë dhe në 2009-n kam qenë në Kosovë. Jam shpallur kampion ndërkombëtar dhe prej

vitit 2010 kam filluar bashkëpunimin me Federatën e Teakwandos së Kosovës. Zakonisht vijmë me shkollën time, të cilën e kam hapur që nga viti 2011, të marrim pjesë në

Kampionatin e Kosovës për Teakwando dhe kemi mjaft sukses", ka thënë Krasniqi. Përpos sukseseve personale, Krasniqi ka hapur edhe një shkollë të Teakwandos, ku me punën, përkushtimin dhe angazhimin e tij, nxënësit e kësaj shkolle kanë arritur suksese të njëpasnjëshme, duke marrë kështu dy medalje botërore dhe gjashtë medalje evropiane. "I kemi 50 nxënëse, 15 garues që marrin pjesë në kampionatin kombëtar dhe ndërkombëtar. Kemi gjashtë tituj evropianë dhe dy botërorë. Kemi marrë pjesë në disa shtete deri në Afrikë e Izrael, domethënë edhe në Evropë në shumë shtete... I kemi 50 % afërsisht shqiptarë, 50 %

zvicëranë dhe të tjerë... Më shumë i kemi shqiptarë. Jemi krejt shqiptarë të Kosovës, shqiptarë të Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Jemi bashkë", ka deklaruar ai. Krasniqi ka dhënë një mesazh për të gjithë rininë e qytetit edhe nga vjen vetë, Rahoveci, të cilën e ka këshilluar që sa më shumë të merret me sport. "Rinia e Rahovecit duhet të merret sa më shumë me sport, pavarësisht se në Komunën e Rahovecit nuk ka shkolla të Teakwandos në Komunën e Rahovecit, por ka shumë sporte të tjera dhe kemi shumë fat që kemi një kryetar që na mbështet si sportistë dhe na shton kulturën e rinisë", ka përfunduar Krasniqi.

## Hoxha operohet të martën

**SUHAREKË, 21 QERSHOR** - Anësori i Ballkanit, Arbër Hoxha, ka konfirmuar se ka pësuar lëndim të rëndë në seancën stërvitore para ndeshjes kundër Trepçës '89.

Futbollisti ka bërë me dije se i ka këputur ligamentet e gjurit dhe do t'i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjike. "Është e vërtetë, jam lënduar gjatë seancës stërvitore të ditës së

shtunë dhe, pas ekzaminimeve mjekësore, del se i kam këputur ligamentet e gjurit. Të martën pritet që të hyj në operim", ka thënë Hoxha për "GazetaSheshi".

Hoxha ka qenë standard gjatë këtij edicioni për klubin nga Suhareka, prandaj do t'i mungojë skuadrës në ndeshjet e mbetura të sezonit.



## Rooney: Liverpools mund të dominojë për një dekadë

LIVERPOOL, 21 QERSHOR - Ish-sulmuesi i Manchester Unitedit, Wayne Rooney, beson se Liverpools mund të dominojë për 10 vjet, por vetëm nëse Jurgen Klopp ndjek hapat e

Aleks Fergusonit duke qëndruar për një kohë të gjatë. Të kuqët janë drejt fitimit të kampionatit pas 30 vjetësh pritje pasi janë të shpëputur 22 pikë nga ndjekësit më të afërt. Rooney beson se

Liverpools mund ta përsërisë dominancën që ka pasur Manchester Unitedi në kohën e Fergusonit. "Skuadra e Liverpoolsit është e re dhe të gjithë lojtarët kryesorë kanë

kontrata afatgjata. Liverpools mund të dominojë për një dekadë, por vetëm nëse Kloppi qëndron për një kohë të gjatë në 'Anfield Road', ka thënë Rooney për "The Times".



## Besa dhe Ferizaj fitojnë finalet e para

PEJË, 21 QERSHOR - Kampionia në fuqi e Superligës në hendboll, Besa Famgas, ka vazhduar me fitore, pasi në palestrën "Karagaçi" në Pejë e ka mposhtur Prishtinën me rezultat bindës, 38-26. Ishte kjo ndeshja e parë e finales së plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Besa ka fituar të gjitha ndeshjet e këtij edicioni, kurse në finalen e parë ishte e pakonkurrencë. Shkëputja e ekipit pejan ka nisur herët në pjesën e parë. Epërsi bindëse Besa Famgas ka mbajtur gjatë gjithë ndeshjes, kurse tash i duhet edhe një fitore apo një barazim për ta mbrojtur titullin e kampionit. Besa ka dominuar falë lojës së shpejtë dhe kundërsulmeve. Kastriot Jupa ishte më efikas te Besa me 9 gola, derisa me nga 7 gola kontribuan Prce e Gjuka. Te Prishtina më efikas ishte Prekazi me 7 gola. Në Superligën e femrave, Ferizaj e ka fituar ndeshjen e parë të finales së plejofit në palestrën "Bill Clinton"



ndaj kampionit aktual, Istogut (34-29). Ferizaj ka pasur epërsi edhe më të lartë, por istogaset janë afruar paksa në minutat e fundit. Portierja Edona Rogova ka ndaluar shumë gjuajtje të lojtareve të Istogut dhe ka udhëhequr skuadrën e Ferizajt drejt fitores. Ferizaj për herë të parë garon në Superligë dhe tashmë është në avantazh në garën për titull. Ndeshja e dytë dhe vendimtare e

finalës së plejofit do të luhet në mesjavën e ardhshme. Ferizaj ka lojtare me përvojë që në shumë momente kanë bërë dallimin në ndeshjen e së shtunës. Fazlija ka organizuar lojën e Ferizajt, ndërsa ka realizuar gjashtë gola. Kelmendi i shënoi tetë gola, Koneski nëntë gola, kurse Basha shtatë gola. Tek Istogu u dallua Hetemi me 8 gola dhe Ujkiq me 7 gola.

## Kumbulla: Mendoj vetëm për Veronën

VERONË, 21 QERSHOR - Mbrojtësi Marash Kumbulla ishte protagonist i një paraqitjeje shumë pozitive në suksesin e Veronas kundër Cagliari (2-1). Mbrojtësi kuqez i folur pas takimit për DAZN, aty ku vlerësoi ndeshjen e skuadrës dhe shpjegoi se pse nuk i bën përshtypje interesimi i klubeve të mëdha italiane. "Kishim një dëshirë të madhe për t'u kthyer në fushë. Ishte një fitore e bukur, të gjithë luajtëm mirë, disa prej nesh shkëlqyen. Nuk jemi akoma në 100%, por stërvitjet po na ndihmojnë të kthehemi gradualisht ata që ishim në muajin mars. Ftohtësia ime në



lidhje me interesimin e Juventusit dhe Interit? Kështu jam unë. Le të themi se kjo është meritë e atyre që më rrethojnë:

shokëve të skuadrës, trajnerit dhe klubit, të cilët më kanë ndihmuar shumë", ka thënë Kumbulla.

## Fury: Mike Tysoni e as Muhammad Ali nuk do t'ia dilnin me mua

Boksieri Tyson Fury mendon se është boksieri më i mirë i të gjitha kohëve. Ai ka dhënë një intervistë duke lëshuar deklaratat arrogante të cilat nuk janë pritur mirë nga tifozët e boksit. "Harrojeni Mike Tyson, Muhammad Ali, Joe Louis,

Lennox Lewis, George Foreman, Ken Norton, Rocky Marciano, Floyd Patterson, Gene Tunney dhe Jem Mace John L. Sullivan, nëse ktheheni pas nga fillimi, askush prej tyre nuk mund ta mposhtë Gypsy King". "Në asnjë kohë, në mijëra vite, nuk ka

qenë asnjë boksier i peshave të rënda që mund të më mposhtë mua. Jam shumë i fortë, jam shumë i mirë dhe asnjë nuk mund të më mposhtë. Kam shumë stile për ta dhe mund t'ia dal shumë mirë", ka deklaruar ai për "BT Sports".

### SHKURT

#### Thaqi: Tri pikë të rëndësishme për Prishtinën

Kapiteni i Prishtinës, Armend Thaqi, është i lumtur se skuadra e tij arriti fitore kundër Dukagjinit (4-1) me golat e shënuara nga asistimet e tij. "Dikush duhet të asistojë. Nga shumë harkime që pata u realizuan tre gola dhe kjo ka shumë rëndësi", ka thënë kapiteni Thaqi. "Janë tri pikë të rëndësishme pas një ndeshje të vështirë që patëm ndaj një Dukagjini jo të fortë, por kemi kundërshtarë të tjerë të fortë dhe për këtë arsye edhe doli ndeshje e fortë. Thjesht, vazhdojmë tutje", ka shtuar Thaqi.

#### Vdes talenti i Las Palmasit

Talenti 17-vjeçar i Las Palmas, Horge Sanchez Vaka, ka humbur jetën ditën e shtunë së bashku me një 15 vjeçar, duke u mbytur në kanal Orelana në Badahoz, raportojnë mediat spanjolle. 17-vjeçari ka qenë pjesë e të rinjve të Las Palmasit dhe, siç njofton klubi spanjoll, vendi në skuadrën e parë për Vakan ishte i garantuar. Sanchez nga sezoni i ri duhej t'i bashkohej skuadrës së parë të Las Palmas, por që u largua shumë herët nga kjo jetë. "Las Palmas me keqardhje të thellë njofton për vdekjen e lojtarit tonë në kategorinë e kadetëve, Jorge Sanchez Vaka. Ne i shprehim ngushëllimet tona familjes dhe miqve të tij", thuhej në deklaratën e klubit spanjoll.

#### Pjaniqi, telashe me trajnerin Sarri

Ka raportime se Miralem Pjaniq nuk do të aktivizohet në ndeshjen e sotme që Juventusit do të luajë kundër Bolognas pas një tensioni që ka pasur me trajnerin Maurizio Sarri në stërvitje. Sipas "La Stampa", ka pasur një përplasje në stërvitje mes mesfushorit dhe trajnerit të tij. Pjaniq ka qenë i lakuar për një transferim te Barcelona. Edhe Cristiano Ronaldo është i frustruar me faktin se po përdoret nga Sarri si sulmues qendror në vend të Higuainit.

#### Guardiola: Ndaj Realit do të luajmë aty ku thotë UEFA

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, është i përgatitur ta shohë zhvendosjen në një vend tjetër të ndeshjes kthyes ndaj Real Madridit në Ligën e Kampionëve. City kishte arritur ta befasojë Realin në ndeshjen e parë në "Santiago Bernabeu" duke i mposhtu me rezultat 2-1. Ndeshja kthyes pritej me interesim të madh, por pandemia e koronavirusit ka bërë që ndeshjet dhe futbollit të jetë i pezulluar për më shumë se tre muaj. Tashmë janë rikthyer kampionatet evropiane të futbollit, ndërsa pas përfundimit të tyre pritet të rikthehen edhe ethet e Ligës së Kampionëve.

UEFA konfirmoi se ndeshjet do të zhvillohen më 7 ose 8 gusht, por City duhet ta luajë ndeshjen kthyes diku tjetër dhe jo në Etihad. "Ne do të përshtatemi me ato që thotë UEFA. Është një situatë e jashtëzakonshme tani në të gjithë botën, jo vetëm në futboll. Nëse UEFA thotë se ne do të luajmë diku tjetër për situatën e shëndetit dhe sigurisë, atëherë do t'i ndjekim udhëzimet e saj", ka thënë fillimisht Guardiola. "Ne do të dëshironim të luanim në stadiumin Etihad, por nëse UEFA vendos të transferohet në një vend tjetër për të luajtur për sigurinë dhe shëndetin e të gjithë neve dhe lojtarëve të Madridit dhe stafit, ne do të përshtatemi me ato që thotë UEFA", ka shtuar Guardiola.

## Tre të vrarë në Britani, policia e cilëson “incident terrorist”

Londër, 21 qershor - Tre persona kanë vdekur dhe tre të tjerë janë plagosur rëndë pas therjeve me thikë në një park në Reading, në perëndim të Londrës, njoftoi policia. Një burrë 25 vjeç është arrestuar në vendin e ngjarjes, nën dyshimin se është autori i vrasjeve. Policia

britanike po e trajton këtë si incident terrorist dhe njësitet anti-terror janë duke udhëhequr hetimet. Burimet nga sektori i sigurisë kanë thënë për BBC se personi i arrestuar besohet se është nga Libia. Një dëshmitar okular ka thënë për BBC se e ka parë një person të ketë

hyrë në mesin e disa grupe njerëzish në park dhe ka tentuar që t'i thërë ata. Zyrtarët policorë thanë se aktualisht nuk kanë ndonjë të dyshuar tjetër për këtë incident që ndodhi rreth orës 19:00 sipas kohës lokale, më 20 qershor, por thanë se ende nuk e dinë motivin e sulmit.



## Boltoni mund ta publikojë librin e tij, dështon përpjekja e administratës së Trumpit për ta bllokuar

NJU JORK, 21 QERSHOR - Ish-këshilltari për siguri kombëtare në Shtetet e Bashkuara, John Bolton, mund ta publikojë librin e tij, vendosi një gjykatës në ShBA, pavarësisht prej përpjekjeve të administratës Trump për ta bllokuar këtë libër. Administrata e presidentit Donald Trump ka shprehur shqetësim se libri i Bolton mund të ketë informacione të klasifikuara. Vendimi i gjykatësit Royce Lamberth po shihet si fitore për Boltonit, megjithëse Shtëpia e Bardhë është zotuar se do të vazhdojë ta kundërshtojë

botimin e memoarit të ish-këshilltarit për siguri kombëtare. Gjykatësi, megjithatë, tha se Boltoni nuk kishte marrë leje nga Shtëpia e Bardhë për informacionet e përdora në libër, megjithëse Boltoni ka deklaruar se libri do të dërgohet për rishikim nga administrata amerikane. Presidenti amerikan Donald Trump ka shkruar në “Twitter” se Boltoni “ka shkelur ligjin duke përdorur informacione të klasifikuara. Ai duhet të paguajë çmim të madh për këtë gjë. Kjo nuk guxon të ndodhë edhe një

herë”. Libri i Boltonit, “Dhoma ku ka ndodhur: Kujtime nga Shtëpia e Bardhë”, pritet të publikohet më 23 qershor. Disa pjesë të librit të Boltonit tashmë janë publikuar në disa gazeta. Trumpi pati shkarkuar Boltonin nga pozita e këshilltarit për siguri kombëtare shtatorin e vitit 2019. Shtëpia botuese “Simon and Schuster” e ka përshkruar përmbajtjen si “libër që Donald Trumpi nuk dëshiron që ju ta lexoni”. Sipas skriptës së publikuar nga shtëpia botuese, Boltoni e përshkruan administratën Trump si kaotike.



## Afër 50 000 të vdekur nga Covid-19 në Brazil



BRASILIA, 21 QERSHOR - Brazili është afër arritjes së shifrës prej 50 000 të vdekurve nga sëmundja Covid-19, teksa ky shtet i Amerikës Jugore ka konfirmuar mbi 1 milion të infektuar nga ky virus. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, 49 976 persona kanë vdekur në Brazil nga koronavirusi deri më 20 qershor. Vetëm gjatë 20 qershorit në këtë shtet janë regjistruar 1 022 viktima. Brazili, shteti me popullsinë më të madhe në Amerikën Latine, me rreth 211 milionë banorë, ka konfirmuar rastet e para me

Covid-19 më 26 shkurt dhe ka kaluar shifrën prej 1 milion rastesh më 19 qershor. Ekspertët thonë se numrat realë mund të jenë shumë më të larta për shkak se në vend ka mungesë të testimeve në masë. Presidenti brazilian Jair Bolsonaro është kritikuar për shkak të mënyrës se si po e menaxhon krizën. Ai ka kritikuar distancën sociale, duke thënë se ajo është një masë që mbytet vendet e punës dhe është më e rrezikshme se vetë virusi. Pavarësisht prej shifrave të larta,

në Brazil më 11 qershor janë hapur qendrat tregtare në dhjetëra qytete. Vetëm Shtetet e Bashkuara kanë numër më të lartë të viktimave se Brazili. SHBA-ja mbetet shteti i goditur më së keqi nga pandemia me 119 654 vdekje dhe mbi 2.2 milionë raste të konfirmuara me koronavirus. Por, SHBA-ja më 20 qershor, në ditën e dhjetë radhazi, regjistroi më pak se 1 000 të vdekur nga koronavirusi në baza ditore, thuhet në të dhënat e publikuara nga Universiteti “Johns Hopkins”.

## Spanja heq kufizimet për turistët e huaj

MADRID, 21 QERSHOR - Spanja ka nisur ta rihapë industrinë e saj të turizmit, duke hequr kufizimet për vizitorët nga Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Bashkuar. Të gjithë turistët që do të vijnë do t'u matet temperatura në aeroporti, do t'u merren të

dhënat nëse ata kanë qenë të infektuar me koronavirus dhe hollësitë e tjera personale. Me heqjen e kufizimeve, Spanja i jep fund gjendjes së jashtëzakonshme që ishte në fuqi për tre muaj. Megjithatë, maskat e fytyrës duhet të mbahen në ato vende publike

ku distancimi fizik është i pamundur që të mbahet. Spanja ka regjistruar mbi 245 000 të infektuar me koronavirus dhe 28 000 të vdekur nga ky virus. Në vit Spanjën e vizitojnë rreth 80 milionë turistë. Kjo industri përbën 12 për qind të GDP-së së vendit.



## Një i vdekur nga një shpërthim në një ndërtesë në Kiev

KIEV, 21 QERSHOR - Të paktën një person është vrarë pas shpërthimit të gazit në një ndërtesë banimi në kryeqytetin ukrainas, Kiev, thanë autoritetet. Dhjetëra persona

mund të jenë të bllokuar nën rrënojat e ndërtesës, pasi katër katet e banesës nëntëkatëshe u shkatërruan, tha në një njoftim Shërbimi Shtetëror i Emergjencës. “Deri më tani

kemi gjetur një person të vdekur, ndërkaq 21 persona janë evakuuar. Tre persona janë liruar nga spitali dhe evakuimi i mëtejshëm i banorëve po vazhdon”, thuhet në njoftim.

Ende nuk është e qartë se sa persona ishin në ndërtesë në momentin e shpërthimit të gazit, ndonëse autoritetet raportuan se kanë evakuuar 21 persona.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

